



RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Specializim afatgjatë (SPA) në
“Kirurgji Orale”
Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e Vlerësimit:

Prof. As. Dr. Nazmi Koçi

Nazmi Koçi
Nazmi

PhD. Erlind Pepla

DR ERLIND PEPLA
[Signature]

Janar 2021

Të dhëna të përgjithshme

Për programin e studimit Specializim afatgjatë (SPA) në Kirurgji Orale të ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron/ Departamenti	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Departamenti i Stomatologjisë
3	Urdhëri/VKM i licencimi	Urdhër MASH Nr. 428, datë 05.09.2011
4	Urdhëri i riorganizimit	Urdhër MASR Nr. 514, datë 24.10. 2019
5	Titulli i programit të studimit:	Specializim afatgjatë (SPA) në "Kirurgji Orale"
6	Cikli i studimit:	Cikli i tretë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	240 Kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishte (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	8
16	Stafi akademik PAE/PAK	24/17
15	Numri studentëve	Brezi 2014-2017 11 studentë Brezi 2019-2013 36 studentë

Nazmi Hoxhi
Mirë

Dr. Edmond Dera
[Signature]

HYRJE

Ky program studimi i ciklit të tretë **Specializim Afatgjatë (SPA) në "Kirurgji Orale"**, është riorganizuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore të Albanian University, bazuar në kërkesat e ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i studimit është hapur me Urdhër MAS Nr. 428, datë 05.09.2011 dhe riorganizuar në masën mbi 20% me Urdhër të MASR Nr. 514, datë 24.10.2019, bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr.18 datë 19.06.2018, nga "Kirurgji" në "Kirurgji Orale" dhe nga 3 vite akademike tashmë ofrohet me 4. Ky program ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe gjatë të cilit realizohen 240 Kredite (ECTS). Ai është riorganizuar në përputhje me Urdhërin e MASH Nr.75, datë 18.02.2013, "Standarteve për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të Specializimeve Afatgjata në fushën e mjekësisë". Në përfundim të studimeve, specializanti pajiset në Diplomë Specializimi në "Kirurgji orale" që i korrespondon Nivelit 8 të Kornizës shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 27, datë 19.05.2017 sipas të cilit akreditimi ishte i vlefshëm për brezat e regjistruar deri në vitin akademik 2013-2014 dhe më pas duhet t'i nënshtrohej riorganizimit dhe akreditimit sipas legjislacionit në fuqi. Ky program studimi është hartuar në përputhje me strategjinë e arsimit të lartë shqiptar, me strategjinë e IAL dhe me qëllimin e përgatitjes së profesionistëve të aftë në fushën e Mjekësisë dhe Stomatologjisë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVB)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Prof. As. Dr. Nazmi Koci dhe PhD. Erlind Pepla si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatoria teknike e ASCAL Xhiliola Bixheku.

Më 18.01.2021 përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.31 Prot., datë 18.01.2021 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 61/1 Prot., datë 25.01.2021, institucioni në përgjigjen e sjellë shpreh dakordësinë e gjetjeve të reflektuara nga GVJ dhe se do të mbajë në vëmendje rekomandimet e lëna nga vlerësuesit e jashtëm. Draft –RVJ kthehet në Raport Final.

Nazmi Koci
Dr. Erlind Pepla

Dr. Erlind Pepla
Dr. Nazmi Koci

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

1. Të rritet numri i stafit akademik me kohë të plotë për realizimin e këtij programi studimi.
2. Të ngrihet një strukturë spitalore pranë Universitetit privat "Albanian University" në funksion të këtij programi studimi.
3. Të rritet numri i rasteve klinike të trajtuara për çdo specializant në mënyrë të tillë që të nxirren kirurgë oral kompetentë në këtë fushë.
4. Të pasurohet e të përmirësohet literatura me tituj shqip.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. Në lidhje me rekomandimin e parë: Njësia bazë e IAL ka punuar me kujdes në këtë drejtim. Referuar edhe numrit konkret të kandidatëve që vijojnë këtë program studimi në SPA për Kirurgji Orale, janë bërë korrigjimet e nevojshme dhe rekrutimet e duhura në mënyrë që të zbatohen kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore në këtë drejtim. Përmirësimet në strukturën e stafit nuk kanë qënë vetëm të karakterit sasior, por edhe kanë synuar përmirësimin cilësor të stafit akademik të përfshirë në realizimin e këtij programi. Është patur parasysh dhe synuar plotësimi i stafit akademik lidhur me numrin, shkallën e kualifikimit, titujve dhe gradave shkencore dhe specializimin në fushën përkatëse që i korrespondon këtij programi SPA. Kujdes është bërë që të korrigjohen edhe raportet midis PAE e PAK si dhe atij të ftuar për këtë program studimi. Duke shqyrtuar këtë program studimi rezulton se anëtarët e stafit akademik, specialiteti dhe nënspecialiteti i tyre si dhe fusha e kërkimit përputhen me përmbajtjen e programit, të studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve dhe lëndëve që zhvillojnë. Në këtë program studimi afatgjatë IAL ka aktivizuar 24 PAE, nga të cilët 1 Akademik, 5 Prof.Dr., 2 prof.As.Dr., dhe 12 Dr/PhD dhe 4 pa tituj. Marrin pjesë gjithashtu në këtë program studimi edhe 16 PAK, të cilët mbajnë tituj e grada si më poshtë: 6 janë Prof. Dr., 5 Prof.As.Dr. 5 PhD/Dr. Me këtë përbërje të stafit akademik kjo IAL plotëson kërkesat e ligjit të Arsimit të lartë 80/2015 dhe të akteve nënligjore që burojnë prej tij. ***Institucioni e ka pëmbushur rekomandimin.***

2. Në lidhje me rekomandimin e dytë: pranë këtij IAL nuk funksionon një strukturë e mirëfilltë spitalore në funksion të shërbimit ndaj pacientëve dhe të këtij programi studimi. Institucioni është kujdesur që të ngriejë një strukturë të posaçme në përbushje të rekomandimeve të eksperteve të lëna për realizimin e këtij programi studimi. Ai ka ngritur një strukturë të emërtuar "Day Hospital" që ka personel shërbimi 24 orësh. Në raste kur konsiderohet e nevojshme ka lidhur një marrëveshje dhe siguruar bashkëpunim me Spitalin Universitar të Traumës dhe me spitalin Salus. Për kushtet specifike të këtij programi studimi, të emërtuar "Kirurgji Orale" dhe gamën e interveneteve që ai duhet të kryej, kjo detyrë duhet konsideruar e plotësuar. Për një gamë operacionesh më të avancuara dhe ndërhyrje më të komplikuar, është e nevojshme jo vetëm një strukturë solide e funksionale spitalore, por edhe pajisia e saj me 1-2 reanimator dhe së paku 2 shtretër reanimacioni. ***Institucioni e ka pëmbushur pjesërisht rekomandimin.***

Naxhije Rexhi
Meksi

DR. EDLIND REXHA
Edlind Rexha

3. Në lidhje me rekomandimin e tretë: njësia bazë për realizimin e këtij programi, ka vlerësuar me prioritet mundësinë e realizimit të këtij programi studimi si nga ana teorike, sidomos nga ajo e praktikave profesionale. Me gjithë vështirësitë e krijuara nga situata e Pandemisë së virusit COVID - 19, programi teorik është zhvilluar pa pengesa në format e njohura, por dhe ato të rekomanduara për këtë situatë. Problemi ka qënë më i ndërlikuar për interventet operatore për të cilat programi parashikon një numër të caktuar ndërhyrjesh dhe që detyra është lënë që të shihen më tepër ato. Numri i rasteve klinike që janë trajtuar nga specialistët në këtë program ka ardhur në rritje. Shumica e tyre janë realizuar në Klinikën Stomatologjike “Çerciz Mingomataj” me 70 shtretër, e cila ka një repart kirurgjie të kompletuar e të pajisur sipas kërkesave të kohës për kirurgjinë ambulatorë. Numrin e shtuar të interventeve që janë zhvilluar në këtë Klinikë e ka stimuluar edhe fakti se Institucioni ka implementuar kryerjen e këtyre ndërhyrjeve pa pagesë, gjë që ka sjell shtimin e numrit të operacioneve dhe të nozologjive të veçanta që operohen në këtë institucion. Në këtë institucion janë kryer ndërhyrje operatore nga specialistët në mbikqyrjen e pedagogëve të aftë vendas dhe të huaj që ka ndikuar dukshëm në nivelin e përgatitjes së tyre. Në një analizë të aktivitetit të kësaj Klinike të zhvilluar me të dhënat e vetë institucionit, ka rezultuar se për një periudhë prej 14 vjetesh totali i punimeve të saj ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit, me një mesatare vjetore prej 228 operacionesh në vit, ndërsa në 5 vitet e fundit me një mesatare vjetore prej 358 operacionesh në vit. Në kushtet e veçanta të situatës që po kalojmë, janë njohur edhe intervente që janë kryer nëpër klinka stomatologjike shtetërore apo private që janë kryer nga specialistët në mbikqyrjen e specialistëve atje dhe që janë dokumentuar e relatuar nga specialistët dhe drejtuesit e tyre me dokumentacion të rregullt. ***Institucioni e ka përmbushur rekomandimin.***

4. Në lidhje me rekomandimin e katërt: Ka patur një vëmendje më të shtuar të IAL edhe lidhur me literaturën bazë shkencore në gjuhën shqipe që shërben për realizimin e këtij programi. Njësia bazë në çdo fillim viti akademik e ka shqyrtuar këtë problem. Realisht ky është një problem i madh i gjithë arsimit të lartë mjekësor shqiptar. Albanian University që në fillimet e tij ka patur një politikë më të qartë dhe ka synuar në sjelljen e teksteve bazë nga literaturë e zgjedhur bashkëkohore botërore dhe ka bërë përkthime e përshtatjen e tyre sipas kërkesave të arsimit të lartë mjekësor shqiptar. Kjo është një përvojë e mirë nga e cila kanë përfituar edhe institucione të tjera të këtij sistemi arsimor. Lidhur me këtë program studimi, në çdo fillim të vitit akademik janë rishikuar syllabuset e lëndëve e të moduleve që zhvillohen dhe është përcaktuar literatura kryesore dhe ajo ndihmëse që është zhvilluar. E gjithë literatura e disponueshme stomatologjike që është botuar në gjuhën shqipe, sidomos ajo në fushën e Kirurgjisë stomatologjike, ndodhet në bibliotekën e institucionit dhe është e disponueshme për specialistët që marrin pjesë në këtë program studimi. Literatura mjekësore shqiptare që lidhet me realizimin e këtij programi studimi është pasuruar me 25 tituj të rinj librash të këtij profili, një pjesë e të cilave kanë lidhje direkte me programin që po zhvillohet. Kjo është një detyrë që mbartet edhe nga puna e autorëve dhe pedagogëve të këtij sektori për përgatitjen e teksteve bazë bashkëkohore në gjuhën shqipe. Nëse do të bëjmë një analizë brënda vetë sektorit të stomatologjisë, Kirurgjia është një degë pararojë e saj në këtë drejtim. ***Institucioni e ka përmbushur rekomandimin.***

Varvara Hoxhi
Hoxhi

Dr. Edlira Peci
Peci

POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË SPA

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Misioni dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit; Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për pëmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, etj)

Misioni dhe objektivat e programit të studimit të ciklit të tretë, specializim afatgjatë në “Kirurgji Orale” përfshihen me misionin dhe qëllimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Parimet mbi të cilat është hartuar ky program studimi janë ato të lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilesisë së mësimdhënies, efektshmërisë dhe eficientës maksimale në përgatitjen teorike dhe praktike të kandidatëve që studiojnë në këtë program.

Misioni dhe qëllimi i programit është në përshtatmëri me misionin e Albanian University, për arsim cilësor universitar, edukim me vlera të larta etike dhe profesionale, aftësim në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim që të realizohet përgatitja e specialistëve të aftë profesionalisht, me synimin e qartë që të çojnë përpara shërbimin shëndetësor të vendit tonë dhe të ruajnë e sigurojnë shëndet të mirë të gojës dhe të organizmit në përgjithësi.

Ky program specializimi afatgjatë synon të edukojë profesionalisht dhe ajo etike kandidatët që preferojnë të zgjedhin atë, të cilët në përfundim të tij të ofrojnë një shërbim në fushën e Kirurgjisë Orale sa më cilësor, të specializuar e bashkëkohor për t’ju ardhur në ndihmë me profesionalizëm dhe ekspertizë pacientëve shqiptar, po që nevoja edhe atyre të huaj. Specializantët marrin gjatë periudhës së studimit në këtë program 4 vjetor njohuri teorike dhe praktike të mjaftueshme dhe të qëndrueshme, për të ushtruar funksionet e mjekut specialist në fushën e Kirurgjisë Orale. Për këtë qëllim IAL ka hartuar një kurrikul të pasur dhe bashkëkohore dhe është konsultuar me programe të tilla të ngjajshme të mjaft universiteteve brënda vendit dhe të Europës e më gjerë.

Ky program studimi është licensuar sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 428 datë 05.09.2011 me emërtimin SPA në Kirurgji. Me ndryshimet që ndodhen me ligjin për Arsimin e lartë 80/2015, bazuar në Standartet dhe Akreditimin e Programeve të studimeve për Specializimet Afatgjata në fushën e mjeksisë, kjo kurrikul është riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.18 datë 19.06.2018, në masën mbi 20% dhe është miratuar me urdhër të MASR Nr. 514, datë 24.10.2019. Programi i studimit SPA në “Kirurgji Orale” ofrohet me 4 vite akademike /240 ECTS dhe ka filluar veprimtarinë akademike në vitin 2019-2020.

Objektivat e programit të SPA në Kirurgji Orale konsiderohen të përgjithshme dhe specifike.

- Objektiv të përgjithshëm të këtij Programi Studimi, IAL Albanian University ka që të realizojë formimin e specializantëve me kulturë të lartë profesionale dhe etike në fushën e mjeksisë, të stomatologjisë, veçanërisht të Kirurgjisë Orale.

- Si objektiva specifike konsiderohen që pas përfundimit të tij të arrihet:

a) Përvetësimi i metodologjive të kërkimit shkencor për të realizuar veprimtari krijuese të pavarura si artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarte për kërkimin e shfrytëzimin e literaturës, referenca, indekse etj.

Veronica Koci
Shkollë

DR. ERIND BEGA
[Signature]

b) Punë të pavarur si specialist në Klinikat stomatologjike publike e private dhe në stacionare e në spitale lidhur me ndërhyrjet e nevojshme me karakter kirurgjikal në regjionin oral dhe për disa nozologji të shpeshta edhe për regjionin përreth gojës e sektorët pranë saj sipas kurrikulës së studimit.

c) Përdorimi i burimeve të informacionit dhe administrimi shkencor i tij si në Biblioteka, në internet etj.

d) Përdorimi i teknologjive dhe i pajisjeve bashkëkohore operatore në fushën e specialitetit të fituar.

e) Përvetësimi i metodave të avancuara e të diferencuara të trajtimit multidisiplinar të pacientëve.

f) Njohja dhe përvetësimi i terminologjisë bashkëkohore të specialitetit lidhur me fushën specifike të këtij programi studimi.

Në planin e zhvillimit të IAL, Albanian University, ka përcaktuar Strategjinë e zhvillimit institucional sipas afateve kohore.

1. Strategjia afat shkurtër: lidhet me përmbushjen e zbatimin e programeve cilësore të studimit, të tilla që të jenë të krahasueshme me kurrikulat e nivelit europian të fushës përkatëse. Kjo është e planëzuar që në këtë nivel të realizohet edhe përgatitja profesionale dhe ajo e kërkimit shkencor të kandidatëve sipas fushave të studimit. Programi i studimit të ciklit të tretë, SPA në “Kirurgji Orale”, zhvillohet në përputhje me këtë strategji të zhvillimit të Institucionit.

2. Në strategjinë afatmesme të zhvillimit institucional të Albanian University, lidhur me realizimin e këtij programi është planifikuar të realizohen studime të përbashkëta si dhe binjakëzim me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Një bashkëpunim i tillë është realizuar konkretisht me disa shkolla të larta brenda e jashtë vendit dhe përfshirjen në zbatimin e kërkesave të këtij programi të 6 pedagogëve italianë nga të cilët 2 janë PAE janë me titull Prof.Dr. dhe specialistë të njohur të Kirurgjisë Orale, ndërsa 4 të tjerë janë PAK, specialistë të fushës dhe kanë tituj e grada shkencore.

3. Në strategjinë afatgjatë ky IAL, ka parashikuar ndryshime cilësore të infrastrukturës, ka projekte ambicioze strategjike dhe synon të jetë një Institucion konkurrues brenda vendit dhe me gjërë dhe të realizojë përgatitjen e nivelit të lartë të specialistëve në fushat e studimit që ka ofruar. Programi i ciklit të tretë, SPA në Kirurgji Orale është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të këtij IAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI I - SYNIMET DHE QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT, KUADRI I PËRGJITHSHËM	
Standardi I. 1- Programet e studimeve specializuese afatgjata në mjekësi ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: misioni dhe qëllimi i tyre është shprehur qartë.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të specializimeve afatgjata është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Përmbajtja e programit të ciklit të tretë, SPA në Kirurgji Orale” është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.80/2015 “Mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.SH.” konkretisht me pikën 9 të nenit 35 të këtij ligji. Ky program studimi është hartuar dhe plotëson edhe të gjitha kërkesat ligjore dhe të akteve nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri.

Veronika Hoxhi
Albani

Dr. Enxheta
Sh

Kriteri 2 Institucioni ka një mision të qartë për programet e studimit që ofron.

Programi është i organizuar në lëndë e module dhe vlerësohet me Kredite ECST sipas sitemit vendas dhe atij European të vlerësimit dhe transferimit të tyre, duke realizuar 240 kredite në katër vite akademike.

IAL, ka një mision të qartë për këtë program studimi të ciklit të tretë që ka ofruar. Qëllimi i hapjes dhe realizimit të programit, si dhe objektivat e tij janë të qarta dhe të detajuara dhe krijojnë besueshmëri në realizimin e plotë të tyre. Programi i studimit është hartuar dhe po implementohet sipas standarteve dhe kërkesave të Arsimit të lartë shqiptar dhe të atij European dhe synon të jetë i krahasueshëm me të. Ai ka si synim që tu përgjigjet kërkesave dhe nevojave të tregut të punës në vendin tonë, por që kandidatët që kryejnë këtë program të SPA, të jenë të aftë për të kryer edhe detyrën e specialistit në nivel European nëse këtë do ja u lypë nevoja. Programi merr parasysh zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, karakterin kombëtar të arsimit shqiptar dhe ruan e zhvillon vlerat kulturore të kombit tonë.

Kriteri 3 Qëllimi i programit të studimit dhe rezultatet që priten janë të qarta.

Qëllimi i këtij programi studimi është i qartë. Ai synon të përgatis Specialistë të aftë e të mirinformuar në fushën e Kirurgjisë Orale që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës si në shërbimin stomatologjik publik ashtu edhe në atë privat. Ata, synojnë të zotërojnë jo vetëm kompetenca të plota profesionale në nivelin e specialistit të fushës, por edhe në nivel të lartë të bashkëpunimit e bashkëveprimit të punës në ekip dhe të raporteve të etikës mjekësore të kohës me pacientët dhe me kolegët e bashkepunetorët e tjerë. Të gjitha masat organizative janë marr që këto synime të realizohen dhe rezultatet e pritshme të këtij programi studimi jo vetëm janë hartuar qartë, por edhe zotërojnë premiset e plotësimit të plotë të tyre.

Kriteri 4 Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike.

Ky program studimi ka objektiva të hartuara qartë në fushën profesionale. Aty janë të gërshetuara dhe në harmoninë e nevojshme të gjitha njohuritë teorike që jepen në disiplina të nevojshme bazë të mjeksisë së përgjithshme e asaj orale, me lëndët e formimit të përgjithshëm dhe sidomos me lëndët e formimit karakterizues të programit të studimit. Një ndërthurje e tillë e dijeve teorike mjekësore është premisë për realizimin e suksesshëm të programit. Për veçoritë specifike që ka ky program studimi, këtu janë gërshetuar qartë dhe në mënyrë harmonike e didaktike njohuritë teorike bazë e ato mjekësore me veprimtaritë praktike klinike të këtij specialiteti të ngushtë të fushës

Neaxhë Hoxhi
Hoxhi

Dr. Edlinda Pajza
Pajza

<p>Kriteri 5 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.</p>	<p>së mjeksisë orale.</p> <p>Emërtimi i programit të ciklit të tretë SPA në “Kirurgji Orale” është i drejtë dhe i përligjur për informacionin profesional e shkencor që ai përmban. Ai është i përcaktuar nga korniza shqiptare e studimeve dhe i korrespondon nivelit të 8 të saj. Po të shikohen me vëmendje të gjitha kurrikulat e programit, informacioni që jepet aty, është me një tendencë tejkalimi përtej fushës së Kirurgjisë Orale. Ai përfshin edhe zona të tjera fqinje përreth gojës, ç’ka do t’u jepte mundësinë hartuesve të këtij programi që të jepnin ndonjë titull studimi më të avancuar. Por infrastruktura me shtretër e cila ka nevojë të organizohet e konsolidohet më tej, për momentin aktual është e tillë që përligj pikërisht këtë titull studimi që jepet. Tendencën e dhënies së informacionit edhe për zonat fqinje përreth gojës e konsiderojmë të drejtë pasi organizmi është një tërësi unike organesh që bashkëveprojnë dhe nuk mund të ndahet e parcelizohet në mënyrë strikte në pjesë të veçanta.</p>
<p>Standardi I. 2- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të aprovuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) pasi është marrë mendimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p>	<p>Programi SPA i ciklit të tretë në “Kirurgji Orale”, ofrohet nga Departamenti i Stomatologjisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Ky institucion i arsimit të lartë është akredituar me Vendimin e BA Nr. 01, datë 24.01.2020. Ai ka si bazë mbështetëse për zhvillimin e praktikave profesionale Klinikën Stomatologjike “Çerciz Mingomataj”, që është një institucion i licensuar me numrin serial LN-4768-03-2018, e cila ka një kapacitet prej 70 poltronesh dentarë dhe një seksion të Kirurgjisë me salla operatore dhe infrastrukturën e nevojshme. Në realizimin e këtij programi ky institucion bashkëpunon edhe me Qendrën Spitalore Universitare të Traumës dhe spitalin Salus që janë institucione të licensuara dhe me nivel të lartë të shërbimit shëndetësor edhe në këtë fushë që është objekt i këtij programi studimi. Me këto institucione IAL ka të lidhura marrëveshje bashkëpunimi që janë efektive.</p> <p>Programi i specializimit afatgjatë në “Kirurgji Orale”, ofrohet me kohë të plotë, zgjat 4 vite akademike ku realizohen 240 kredite. Ai përfshin</p>

Maxim Koci

DE ERLENDE PELA

<p>Kriteri 2 Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.</p>	<p>krahas formimit teorik bashkëkohor edhe pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të cilat kryhen në Institucionin që realizon programin, por dhe në Institucionet mbështetëse me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, procedurave dhe protokolleve mjekësore të aprovuara dhe që janë në zbatim në veprimtarinë e tyre. Të gjitha këto procedura janë kryer nga ana e specializantëve nën mbikqyrjen e autoriteteve përkatëse. Për këtë qëllim janë ngarkuar udhëheqës praktike dhe tutorë që janë specialist në Kirurgji Orale.</p>
---	--

Standardi I. 3- Programet e studimeve janë eficientë, në përputhje me misionin institucional.


<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimeve në SPA për Kirurgji Orale, është në përputhje me misionin e AU për të ofruar një arsim cilësor universitar për të tre ciklet e studimit, duke qënë një i tillë i ciklit të tretë. Ai synon edukimin e kandidatëve me vlerat më të mira etike dhe profesionale, zhvillimin e fantazisë dhe të aftësisë së specializantëve për të përvetësuar e realizuar metoda bashkëkohore të kërkimit shkencor. E gjitha kjo ka si synim final formimin e specialistëve të aftë profesionalisht në fushat e komunikimit e të formimit të përgjithshëm që të përballojnë me sukses kërkesat e shërbimit shëndetësor oral si pjesë e rëndësishme e shëndetit të përgjithshëm të njerëzve në fushën e specialitetit të Kirurgjisë Orale.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni bën një planifikim institucional efikas dhe kryen përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve dhe rezulton se programi ka arritje të mira.</p>	<p>Institucioni përgjegjës për realizimin e këtij programi specializimi afatgjatë në Kirurgji orale, AU, ka bërë një planifikim institucional efikas dhe cilësor për realizimin e suksesshëm të tij. Njësia kryesore dhe ajo bazë e këtij institucioni janë pjesë e planit strategjik të tij për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies e zotërimin e aftësive profesionale të nevojshme në nivelin e specialistit bashkëkohor, në fushën që është objekt i këtij programi specializimi. Institucioni ka për qëllim përmbushjen e detyrimeve për realizimin cilësor të këtij programi dhe kjo është realizuar në mënyrë të kënaqeshme siç rezultoi nga vizita në institucion, bashkëbisedimi me të gjithë aktorët që janë aktivizuar në realizimin e plotë të tij dhe sidomos</p>

Vesna Hoxha

DA ERIND PETA

	<p>gjatë diskutimeve të hapura me specialistët e të gjitha grupeve.</p> <p>Përmirësimi i programit të studimit në SPA për Kirurgji Orale është kryer brenda hapësirave ligjore, në përshtatje me kërkesat e tyre dhe në frymën e lirisë akademike dhe konform akteve normative të vetë Institucionit.</p>
<p>Standardi I. 4- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe integrojnë kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane.</p>	<p>Programi i studimeve për SPA në fushën e Kirurgjisë Orale, është përshtatur në strukturë dhe në modalitete të organizimit me programe të ngjashme të nivelit Europian. Së pari kja përafersi vjen nga përmbajtja e vetë kurrikulës së studimit që po realizohet në këtë fushë. Për hartimin e saj janë marr përvojat e përparuara të disa Universiteteve të Europës, kryesisht ato të Italisë me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi që janë efektive. Së dyti, kjo përshtatmëri është realizuar duke aktivizuar një numër të konsiderueshem pedagogësh të huaj. Konkretisht në program marrin pjesë 6 të tillë, prej të cilëve 2 janë PAE, mbajnë titullin shkencor Prof. Dr. dhe janë specialist të njohur në vendin e tyre dhe në gjithë Europën. Kjo u konstatua edhe në takimin me specialistët dhe takimet me stafin akademik. Edhe literatura bazë që përdoret për realizimin e kurrikulës së studimit, sidomos ajo e formimit karakterizues të tij dhe e specialitetit të ngushtë, është marr nga literatura bashkëkohore dhe është përkthyer në gjuhën shqipe. Për këtë fakt mendojmë se AU ka një përvojë positive pasi këtë proces e ka aplikuar që në fillim të veprimtarisë së tij. Po ashtu literatura e rekomanduar në gjuhë të huaj i shërben këtij qëllimi. Zhvillimi i disa leksioneve dhe praktikave në gjuhë të huaj u vlerësua nga specialistët si një risi që i përgatit ata nga ana profesionale dhe shkencore dhe i pajis me aftësinë për të referuar në gjuhë të huaj në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Për të gjitha këto arsye, në mendojmë se ky program studimi në SPA për Kirurgji Orale është i përshtatur me strukturat e programeve homologe europiane.</p>
<p>Standardi I. 5- Programet e studimeve ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	

Vaxhimi Koci


DA CALUD PAPA


Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.

Programi i studimit në SPA për “Kirurgji Orale” përputhet me nevojat e tregut të punës. Ai plotëson një nevojë të tregut tonë të shërbimit stomatologjik sido që të jetë forma e organizimit të tij, në formë shtetërore apo private. Studimi i tregut të punës i paraqitur nga institucioni është i plotë në strukturë dhe metodikë por të dhënat e paraqitura për të argumentuar nevojën e specialistëve të Kirurgjisë orale në vendin tonë nuk qëndrojnë. Sipas kësaj tabele në Shqipëri mangësitë deri në vitin 2020 për personelin shëndetësor janë rreth 970.000 punonjës dhe kjo perfaqëson rreth 13.8 % të kujdesit të pambuluar. Nëse i referohemi kësaj të dhëne numri i përgjithshëm i personelit shëndetësor që të arrij në 100%, rezulton të jetë një shifër prej 7.028.985 punonjës. Por është i njohur fakti se jo numri i punonjësve të shëndetësisë, por as ai i banorëve në Shqipëri nuk arrijnë një shifër të tillë.

Ka plot argumenta të tjerë që tregojnë se tregu shqiptar i shërbimit stomatologjik ka nevojë për këta specialistë. Nga analiza që i është bërë aktivitetit të Klinikës dentare “Çerciz Mingomataj”, rezulton se aktiviteti kirurgjikal i saj zë rreth 22.4% të atij të përgjithshëm. Duke llogaritur se tek Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë (USSH), janë të licensuar rreth 3050 stomatologë, nga e dhëna e vetë institucionit rezulton se do të nevojiteshin rreth 683 Kirurgë Stomatologë. Ka edhe mjaft mënyra të tjera të testimit të tregut i cili realisht ka nevojë për Kirurgje Orale dhe hapja e këtij programi është e motivuar dhe në dobi të shërbimit shëndetësor stomatologjik.

Kriteri 2 Numri i përgjithshëm i specialistëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).

Numri i përgjithshëm i specialistëve, i atyre që kanë mbaruar dhe që vazhdojnë këtë program studimi, është përcaktuar në bazë të politikave shtetërore të zhvillimit në fushën e shëndetësisë, të politikave të zhvillimit institucional të AU dhe të infrastrukturës përkatëse. Ai merr parasysh kërkesat në rritje të pacientëve për shërbime të fushës së Kirurgjisë Orale, si vendosja e implanteve në situata klinike të komplikuar, korrigjimet kirurgjikale të anomalive dento-maksilare, probleme të patologjive të ndryshme të gjëndrave të pështymës apo të artikulacionit temporo-

Veronica Hoxhi

DA ERALIN PAPA

	<p>mandibular që duan trajtim kirurgjikal etj. Sipas të dhënave që ka paraqitur institucioni në studimin e tij jepet një e dhënë që na informon për numrin e saktë të specialistëve të këtij programi. Në vitet akademike 2012-2015 kanë qënë regjistruar 27 specialistë dhe prej tyre janë diplomuar 22 Kirurgë Oral. Në vitin 2014-2015 janë regjistruar 11 studentë dhe ata nuk janë diplomuar akoma. Në vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar 35 specialistë të cilët janë në proces të kryerjes së këtij programi studimi. Shihet se ka një tendencë në rritje të regjistrimit të kandidatëve në këtë program të SPA.</p> <p>Kapacitetet pritëse të IAL, stafi akademik dhe infrastruktura e tij janë në gjëndje të presin një numër më të madh specialistësh në këtë fushë. Në planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë janë parashikuar përmirësime të tjera të cilat janë vërtetë premtuese.</p>
--	---


Standardi I. 14- Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.

AU, publikon në mënyrë të vazhduar materiale të hartuara prej tij dhe që lidhen me vlerësimin e brendshëm të cilësisë së realizimit të këtij programi SPA në fushën e Kirurgjisë Orale. Problemi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe realizimit të sukseshëm të këtij programi edhe pse ka një njësi të posaçme të NJSBC, është detyrë e të gjitha strukturave të këtij institucioni, sidomos të njësisë bazë dhe të asaj kryesore të tij. Në mënyrë periodike janë botuar broshura dhe materiale të tjera informative që japin informacionin e nevojshëm për vlerësimin e brendshëm dhe cilësinë e mësimdhënies. Gjatë vizitës në IAL na paraqeti një material të botuar gjatë muajit tetor 2020, i cili përmbante materiale nga një konferencë shkencore e zhvilluar gjatë këtij muaji lidhur me problematikat e shërbimit mbi shëndetin oral në kushtet e pandemisë së Covid-19. Në të ka disa materiale të botuara që flasin për vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit në kushtet e krijuara.

Albanian University, publikon vazhdimisht punime të specialistëve dhe të pedagogëve të këtij

Vera me Hoxhi


DA EDLUD PALL


Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj.

programi në shtypin mjekësor të shkruar dhe në buletin e tij. Për këtë ai ka paraqitur në dosjen përkatëse një listë me punimet e tyre dhe që gjatë vizitës në institucion u gjet e saktë.

Ky institucion ka mundësinë që punime të tilla ti paraqesë edhe në televizionin e tij (UTV), ku jepet informacion periodik për punën shkencore të institucionit në të gjitha programet e studimit, veprimtaritë akademike ekstrakurkulare që zhvillohen, por edhe për programin në fjalë.

Institucioni që po realizon këtë program studimi publikon rregullisht video e audio që lidhen me veprimtarinë mësimore dhe atë shkencore të tij, ku prezanton punët e studentëve dhe të pedagogëve të tij edhe për programin SPA në Kirurgji Orale.

Këto mund të aksesohen në adresën: (<https://Albanianuniversity.edu.AL/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise>).

Kohët e fundit ky institucion ka botuar një booklet mbi vlerësimin e personelit akademik për institucionin.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit SPA në “Kirurgji Orale” ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, të akteve nënligjore dhe në funksion të zbatimit të misionit dhe objektivave të vetë institucionit. AU ka në strategjinë e vetë të zhvillimit të institucionit, përmirësimin e metodave të mësimdhënies e mësimnxënies, pajisjen e kandidatëve me dije shkencore bashkëkohore dhe shprehi praktike të nivelit kombëtar dhe europian, hapjen e degëve të reja dhe zgjerimin e gamës së studimeve në këtë IAL.

Programi i studimit synon të përgatisë specialistë të aftë e të mirëinformuar në fushën e Kirurgjisë Orale që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës si në shërbimin stomatologjik publik ashtu edhe në atë privat.

Realizimi me sukses i këtij programi shërben për plotësimin e nevojave të tregut të punës dhe synon ti ofroj atij specialistë të përgatitur e me dije e nivel profesional sipas kërkesave të kohës.

Studimi i tregut të punës i paraqitur nga institucioni është i plotë në strukturë dhe metodikë, por të dhënat e paraqitura për të argumentuar nevojën e specialistëve të Kirurgjisë orale në vendin tonë nuk qëndrojnë.

Albanian University publikon në mënyrë të vazhdueshme në faqen web informacion mbi vlerësimin e brendshëm dhe ecurinë e programit të studimit.

Vera me Hoxa
Albania

DA ERALD PATA
[Signature]

2. Struktura akademike e Fakultetit që ofron SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Vendi që zë Fakulteti që ofron SPA në organigramën e IAL (Universiteti/ Fakulteti/ Departamenti), të dhëna për personelin akademik përgjegjës për specializimin afatgjatë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

IAL që ofron këtë program studimi SPA në “Kirurgji Orale”, përbëhet nga organet drejtuese, autoritetet drejtuese, njesitë bazë me karakter mësimor e shkencor dhe nga administrata e tij.

1. Organet drejtuese të FSHM:

- a) Dekanati;
- b) Asambleja e Personelit Akademik;

2. Organ drejtues administrativ:

- a) Administratori i njesise kryesore (Fakultetit);

3. Autoritete drejtuese:

- a) Dekani;
- b) Përgjegjësit e Departamenteve;

Njësi ndihmëse dhe shërbimi në funksion të departamentit të Stomatologjisë:

1) Klinika stomatologjike “Çerciz Mingomataj” e cila funksionon sipas një rregulloreje të veçantë. Personeli akademik përbëhet nga pedagoget me kohë të plotë (PAE), pedagoget me kohë të pjeseshme (PAK), dhe Pedagoget e ftuar (PAF), siç janë të përcaktuar edhe në statutin e AU. Të drejtat dhe detyrat e tyre janë të përgjithshme dhe specifike dhe përcaktohen në rregulloret e institucionit dhe në Kontratat e punës të secilit.

Struktura administrative e Fakultetit të shkencave mjeksore perbehet nga:

1. Sekretaria mësimore:

- a) Kryesekretari i FSHM;
- b) Sekretari i Sekretarisë Mësimore.

Personeli ndihmës Akademik:

1. me karakter mësimor:

- a) Asistentet e Departamenteve;
- b) Asistent pedagoget e praktikave mesimore;
- c) Laborantet;

2. me karakter administrativ:

- a) Sekretaret e sekretarise mësimore;

Organet drejtuese të Programit të studimit Specializim afatgjatë në “Kirurgji Orale” janë:

1. Këshilli drejtues;

Vasim Koci
Mësim

Dr. GJINDI PAPA
Gjind

2. Drejtuesi i Programit të specializimit;
3. Udhëheqësi akademik /klinik;
4. Koordinator i programit të specializimit.

Këta së bashku, kontrollojnë kolegjisht gjithë veprimtarinë akademike dhe administrative të këtij programi studimi të ciklit të tretë.

Drejtuesi i programit të Specializimit i raporton në mënyrë periodike Dekanit të Fakultetit për mbarvajtjen e programit të studimit. Veprimtaria e Oraganeve Drejtuese të programit të Specializimit pershkruhet dhe monitorohet sipas kërkesave të Rregullores së Programit të studimit.

Tregues të matshëm:

- Organigrama e Fakultetit

Fakulteti Shkencave Mjekësore është i organizuar në 3 departamente:

1. Departamenti i Stomatologjisë;
2. Departamenti i Farmacisë;
3. Departamenti i Infermierisë dhe i fizioterapisë;

- Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabela 1)

Në Departamentin e Stomatologjisë janë angazhuar 42 pedagogë PAE nga të cilët: 5 me titullin Profesor, 1 Prof. As, 14 me Dr/PhD, 11 SPA dhe 11 Msc. (nga të cilët 4 në proces Dr.)

Gjithashtu janë angazhuar 33 pedagogë si PAK: 5 Profesor, 5 Prof. As., 14 Dr/PhD, 2 SPA dhe 7 Msc. (nga të cilët 2 në proces Dr.). Raporti PAE/PAK është 42/33.

Në Departamentin e Farmacisë janë angazhuar 18 pedagogë PAE nga të cilët: 2 Prof. As., 9 Dr/Phd, 7 janë me Msc. (nga të cilët 6 në proces Dr.)

Gjithashtu janë angazhuar 16 pedagogë PAK nga të cilët: 4 Profesor, 5 Prof. As., dhe 3 Dr/Phd, 4 Msc (aktualisht në proces Dr.). Raporti PAE/PAK është 18/16.

Në Departamentin e Infermieri dhe Fizioterapisë janë angazhuar 48 pedagogë PAE nga të cilët: 4 Profesor, 2 Prof. i As., 8 Dr/Phd, 10 SPA dhe 24 Msc.

Gjithashtu janë angazhuar 59 pedagogë PAK nga të cilët: 4 Profesor, 10 Prof. As., 14 Dr/ Phd, 19 SPA dhe 20 Msc. Raporti PAE/PAK është 48/59.

Programi i studimit SPA në “Kirurgji Orale” është një program i ciklit të tretë të studimeve dhe organizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore të Albanian University.

Ky është një Institucion i arsimit të lartë jo publik shqiptar që është i akredituar me vendimin e BA Nr.01, datë 24.01.2020.

- Strukturat me të cilat janë bërë marrëveshje.

Për realizimin me sukses të këtij programi studimi, si njësi ndihmëse e Departamentit të Stomatologjise në zhvillimin e praktikave mësimore e profesionale, në funksion të këtij procesi është Klinika Stomatologjike “Çerciz Mingomataj”, me një kapacitet prej 70 poltronesh dentar dhe

Vaxhi Kaci
M. Kaci

DR. ERLIND PANA
[Signature]

nje seksion te posaçem per "Kirurgji Orale". Pranë saj është i atashuar një strukturë me shtretër, Day hospital, e cila ka të organizuar shërbim 24 orësh me personel mjekësor. Në rast nevoja ndihma e specializuar me karakter spitalor mund të jepet edhe në Qendren Universitare të Traumës dhe në spitalin Salus me të cilët kjo IAL ka marrëveshje bashkëpunimi që janë efektive.


Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI II- ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT ORIENTOHEK NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II. 1- Personeli akademik dhe administrativ organizohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.	
<p>Kriteri 1 Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjike për zhvillimin e institucionit.</p>	<p>Struktura akademike dhe administrative e AU, përmbush objektivat e programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale". Objektivat e institucionit për zhvillimin e FSHM, janë pjesë e zhvillimit të përgjithshëm institucional të tij. Ato bazohen në objektivat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë në vendin tonë. Struktura akademike e këtij institucioni, me qëllim realizimin e suksesshëm të këtij programi, ka rekrutuar pedagoge, vendas e të huaj, me eksperiencë në praktikën klinike dhe në mësimdhënie, me tituj e grada shkencore, të aftë e të gatshëm për realizimin me sukses të programit. Në këtë program studimi janë të ftuar e marin pjesë edhe pedagogë nga Universitete të Europës, të cilët zhvillojnë cikle leksionesh apo praktikë për çështje të veçanta. Ata sjellin këtu përvojën e tyre mësimdhënëse, por edhe atë të praktikës klinike të vendeve të zhvilluara europiane. Prej tyre janë hartuar protokolle studimi, por dhe teknika inovative për mjekimin e pacientëve shqiptar sipas përvojës së tyre të përparuar. Një protokoll i tillë është ai i hartuar nga specialisti italian i që ka të bëjë me shpejtimin e rigjenerimit në ndërhyrjet kirurgjikale me teknikat e faktorëve të rritjes.</p> <p>Stafi administrativ i IAL, mbështet realizimin me sukses të këtij programi dhe ka vënë në dispozicion të specializanteve të gjithë infrastrukturën dhe informacionin e nevojshëm. Zhillimi i këtij programi studimi është në harmoni me objektivat strategjike për zhvillimin</p>

Vlora me Kerci
Stavri

DR. ERIND PETA
[Signature]

	e institucionit.
Standardi II. 2- Organizimi i institucionit është në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në përmbushje të misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete një nga të cilët ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programet e integruara të studimeve në fushën e Mjekësisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë.</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti ose Qendra Kërkimore Shkencore janë të përbëra, së paku, nga 3 shërbime/departamente me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p>	<p>Organizimi i institucionit Albanian University është bërë që të përmbushë misionin dhe qëllimin e tij. Ai është i bazuar në kërkesat e Ligjit Nr.80/2015 dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij. Organizimi i Institucionit përmbush edhe qëllimin dhe objektivat e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale” dhe është në harmoni me to, ç’ka përbën garanci për realizimin me sukses të programit në fjalë.</p> <p>Albanian University ka në përbërje të tij tre fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Shkencave Mjekësore • Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike • Fakulteti i Shkencave Shoqërore. <p>Në këto kushte ky institucion ka një Fakultet që ofron studime të integruara në fushën e mjekësisë, të farmacisë dhe të stomatologjisë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore që ka organizuar programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale” ka në ëe të tij tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Stomatologjisë 2. Departamenti i Farmacisë 3. Departamenti i Infermieri dhe Fizioterapisë. <p>Këto Departamente kanë objektiva dhe mision të përcaktuar qartë dhe sipas natyrës specifike për të cilën janë organizuar.</p> <p>Departamenti i Stomatologjisë ka si njësi ndihmëse dhe në funksion edhe të programit të studimit SPA edhe Klinkën stomatologjike “Çerciz Mingomataj”. Në keto rrethana IAL, është i organizuar sipas kërkesave të ligjit dhe plotëson standartin e nevojshem për të kryer me sukses këtë program studimi.</p>
STANDARDI VII - INSTITUCIONI DISPONON NJË RREGULLORE TË DETAJUAR TË PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË	
Standardi VII. 1- Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe përditësohet çdo vit akademik	
	Albanian University disponon rregullore për

Vexhimi Koci


DA ERIND PATA


<p>Kriteri 1 Rregullorja propozohet nga Këshilli i Profesorëve dhe aprovohet nga senati i institucionit që i ofron ato.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja e aprovuar nga senati merr aprovimin nga MSH dhe MASH para hyrjes në fuqi.</p>	<p>tretë, specializim afatgjatë në “Kirurgji Orale” është titulluar “Për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit të specializimit në Kirurgji Orale në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në “Albanian University”. Pasi është hartuar nga një grup profesoresh, ka marrë vlerësimin e strukturave përkatëse dhe është propozuar për aprovim nga Këshilli i Profesorëve. Kjo rregullore është miratuar nga Senati Akademik me Vendimi Nr. 5 date 23.10.2019.</p> <p>Kjo rregullore e programit të studimit në SPA ka kaluar për miratim në strukturat qendrore të Shëndetësisë dhe në MASR., është njohur dhe konfirmuar prej tyre dhe është aktualisht në fuqi. Një kopje e kësaj Rregulloreje është pjesë e Dosjes se paraqitur per vleresimin e programit te studmit te specializimit afatgjate ne “Kirurgji Orale”.</p>
<p>Standardi VII. 3- Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit dhe të këshillit drejtues.</p>	<p>Përzgjedhja e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale” është bërë konform kërkesave të ligjit në fuqi për arsimin e lartë, akteve nënligjore dhe sipas rregullores përkatëse. Përgjegjes i këtij programi studimi ka titullin akademik, Prof. Emeritus dhe ka një veprimtari të pasur kërkimore shkencore e botuese si dhe përvoje të gjatë në organizimin e programeve të këtij niveli.</p> <p>Për mbarevajtjen e këtij programi dhe ecurinë normale të tij është ngritur një Këshill Drejtues, i cili është organ kolegjal pranë njesisë kryesore dhe ka në përbërjen e tij 5 (pesë) antarë, që janë pedagogë me kohë të plotë. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues është bërë me shkresë Nr. 944, datë 28.10.2019, formati së cilës ndodhet në dosjen përkatëse të IAL. Anëtarët e Këshillit drejtues janë figura të njohura të fushës së specialitetit përkatës, me reputacion të lartë pedagogjik e klinik dhe veprimtari të njohur kërkimore e botuese, dy prej të cilëve janë pedagogë të universiteteve italiane dhe të njohur në botën arsimore e</p>

Verim Kuci
Albani

DR. ERLIND PENA
[Signature]

Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dh detyrat e tij.

profesionale në Europë. Kryetari i Këshillit Drejtues është Drejtuesi i programit të specializimit, Akademik, prof. Emëritus A. K. Ai zgjidhet sipas rregullores nga anëtarët e Këshillit me shumicë të thjeshtë votash (50%+1). Kjo kërkesë është e konfirmuar në nenin 15 e 16 të rregullores së programit të studimit.

Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe modalitetet e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës që udhëheq mbarvejtjen e këtij programi. Kualifikimi i mjekut përgjegjës është në përputhje me profilin ku bën pjesë fusha e studimit dhe ka shkallën e duhur dhe titullin shkencor sipas kërkesave për të kryer këtë detyrë, ka eksperiencë profesionale mbi 10 vjet, dhe përvojë klinike në Kirurgji Orale. Udhëheqësi ka miratuar në vazhdimësi planin e punës dhe organizon planin e interveleve me pacientet për specializantët për çdo nozologji të veçantë. Ai ka përcaktuar në çdo rast edhe tutorët e praktikave për çdo grup prej 3 specializantësh. Bashkëpunëtorët e jashtëm janë përcaktuar nga udhëheqësi i programit të studimit me miratimin e Drejtuesit të programit SPA.

Standardi VII. 4- Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit

Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet, nota mesatare, moshë, publikimet e kryera, etj) si dhe kriteret përjashtuese.

Në rregulloren e programit të studimit për SPA në "Kirurgji Orale", janë të përcaktuara qartë kriteret e përzgjedhjes dhe procedurat e pranimit të Specializantëve në këtë program studimi. Në nenin 24 të kësaj rregulloreje janë të përcaktuara e shprehur qartë kriteret për t'u pranuar në këtë program. Në këto kërkesa është theksuar se për t'u pranuar në këtë program studimi, kandidati duhet të zotëroj Diplomë për "Master Shkencor në Stomatologji" ose diplomë ekuivalente më të psh. Diplomë e sistemit të vjetër të pandarë në cikël studimi, por që i përket këtij titulli studimi. Kërkohet gjithashtu nota mesatare sipas kriterëve ligjore, provimi i gjuhës së huaj në një nga 5 gjuhët kryesore europiane, të ketë dhënë provimin e shtetit për profesionet e rregulluara dhe të jetë mjek i licensuar. Kanë përparësi ata

Nota me Kleri
Shqipëri

DR. ERLEN PALLA
[Signature]

Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.

Kriteri 3 Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar (notë mesatare, publikime, etj) si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi (me shkrim, me gojë, praktik, etj).

Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumentave.

që kanë aktivitet shkencor e botime, por kjo varet edhe nga stazhi në punë i kandidatit. Për vitin akademik 2019-2020, shpallja e kriterëve është bërë 2 javë para fillimit të procesit të pranimit dhe shpallja e kriterëve është bërë me Vendim të Senatit Akademik Nr. 42 datë 23.10.2019.

Në rregullore janë të përcaktuar qartë të gjithë dokumentat që duhet të dorëzoj kandidati. Për të gjitha kriteret e mësipërme duhet të paraqitet dokumenti përkatës që vërteton se kushtet që kërkohen janë të plotësuar prej tyre. Dokumentacioni dorëzohet pasi të jetë bërë njoftimi publik për hapjen e programit, në Sekretarinë e specializimeve. Kandidatëve u jepet i gjithë informacioni i nevojshëm për kohezgjatjen e programit dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ana e tyre. Pas kësaj aplikanti pajiset me një çertifikatë aplikimi. Në rregullore është përshkruar mënyra e shpalljes së fituesve.

Rregulloja e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale”, i ka të përcaktuara qartë pikët maksimale që mund të grumbulloj kandidati që konkuron për të fituar të drejtën në këtë program studimi. Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar më shumë pikë, me rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit. Piket totale për t’u pranuar janë 100, të cilat ndahen si më poshtë:
-50 pikë ka testimi/intervista me gojë.
-30 pikë kurse kualifikimi e veprimtari shkencore.

-20 pikë mesatarja e notave. Pas kësaj renditjeje Departamenti bën publike rezultatet, shpall fituesit dhe ju komunikon atyre afatet e regjistrimit.

Në rregullore janë të përcaktuara qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikoj kandidati. Po ashtu personeli administrativ dhe sekretaria përkatëse kanë bërë çdo sqarim të nevojshëm dhe kanë dhënë asistencen e tyre lidhur me këtë problem. Numri i kandidatëve aplikantë për këtë program studimi ka qënë i pakufizuar,

Vox me Koca
Alia

DR. ERIND PALLA
ERIND PALLA

Kriteri 5 Aplikanti dorëzon një kërkesë me shkrim sipas formatit të përcaktuar në rregullores dhe që i bashkangjitet asaj. Aplikantit, në momentin e pranimit të dokumentacionit i jepet një vërtetim për aplikimin me numrin e tij identifikues gjatë procesit.

Kriteri 6 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të testeve, radha e zhvillimit të tyre, sa ditë diferencë mund të ketë nga një testim tek tjetri për të njëjtin program dhe për programe të ndryshme specializimi.

Kriteri 7 Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit.

regjistrimi u lejua deri një ditë para konkursit. Konkursi për t'u pranuar në këtë program është kryer me dosje dhe me testim. Numri minimal i të pranuarve sipas rregullores është 0, ndersa ai maksimal në varësi të infrastrukturës që është në dispozicion. Në vitin akademik 2019-2020 në këtë program studimi janë pranuar 35 specializantë, të cilët vazhdojnë studimet pa u ndërprer nga ndonjëri deri tani.

Aplikantët në këtë program studimi, kanë plotësuar një kërkesë me shkrim sipas formatit të paraqitur nga institucioni, një kopje e së cilës ndodhet në dosjen përkatëse që ka paraqitur institucioni dhe atë e kanë shoqëruar me dosjen e kandidatit që përmban dokumentacionin e kërkuar. Sekretaria e specializimeve pasi ka bërë verifikimin formal të gjithë dosjes e ka pranuar atë dhe i ka lëshuar aplikantit një vërtetim me numrin e tij identifikues gjatë procesit.

Në rregulloren e Programit të studimeve është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të testimit. Ai bëhet në dy faza. Në fillim shqyrtohet dokumentacioni i paraqitur, nëse paraqet ai mungesa dhe nëse është konform kriterëve që ka përcaktuar institucioni. Në hapin e mëtejshëm bëhet vlerësimi i tij dhe në ç'shallë kandidati përmbush kriteret e kërkuara dhe bëhet një renditje sipas dokumentacionit të paraqitur. Në këtë fazë të vlerësimit kandidati mund të marr deri në 50 pikë, konkretisht nga nota mesatare e studimeve të larta deri në 20 pikë dhe nga veprimtaria e tij shkencore, pjesëmarrja në aktivitete dhe veprimtaria e tij botuese mund të vlerësohen deri në 30 pikë. Pasi ka përfunduar kjo fazë, kandidatët i janë nënshtruar një testimi me gojë, i cili sipas rregullores mund të vlerësohet deri në 50 pikë. I gjithë ky proces është zhvilluar në mënyrë transparente dhe konform kërkesave të rregullores.

Në rregullore është e përcaktuar qartë mënyra e përzgjedhjes së Komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e tij. Ato janë të shprehura qartë në nenin 25 në rregulloren e programit të studimit. Komisioni

Maxim Kuci
Shkollë

Dr. Erland Palla
Shkollë

Kriteri 8 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.

Kriteri 9 Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specialistëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe taksat që duhet të paguajë specialisti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.

Kriteri 10 Mënyra e vlerësimit dhe argumentet mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.

përzgjedhës i këtij programi është ngritur nga këshilli Drejtues i programit, aprovuar nga Dekani i F.Sh.Mjekësore dhe përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e Komisionit kanë qënë ekspertë të fushës së specializimit, që mbajnë tituj dhe grada shkencore dhe kanë eksperiencë mësimdhënëse në shkollë të lartë në ciklet e integruara dhe në specializime afatgjatë. Anëtarët e komisionit që kanë bërë përzgjedhjen e kandidatëve që vazhdojnë aktualisht këtë program studimi janë zgjedhur brënda këtyre kriterëve dhe i plotësojnë pa mungesa ato.

Në rregulloren e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale”, janë parashikuar qartë mënyrat e vlerësimit të kandidatëve që kanë konkuruar për këtë program, procedurat përkatëse dhe mënyra e vlerësimit të tyre. Gjithashtu janë të hartuara drejt procedurat e përzgjedhjes së fituesve dhe të shpalljes së tyre, deri tek regjistrimi në programin e specializimit. Gjatë vizitës në institucion u verifikuan disa praktika të tilla. Ato rezultuan konform rregullores dhe zbatimit të kriterëve ligjore. Në ballafaqim me specialistët nuk u gjet ndonjë problem në procedura dhe as kishte ndonjë vërejtje nga ana e tyre për pranimin dhe regjistrimin në programin e specializimit.

Dokumentacioni përkatës ruhet në dosjet e specialistëve sipas procedurave të parashikuara në rregullore.

Emërtimi i këtij programi specializimi “Kirurgji Orale”, është bërë i ditur e publikuar nga ana e IAL që në momentin e publikimit zyrtar të hapjes së tij dhe sipas afateve të përcaktuara në rregullore. Specialistët që vijojnë studimet në këtë program në vitin akademik 2019-2020, e konfirmuan këtë dhe nuk kanë ndonjë vërejtje rreth tij. Para regjistrimit në këtë program studimi, specialistëve u është bërë e qartë tarifa e studimit për çdo vit akademik dhe kjo ndodhet e fiksuar edhe në kontratën e përbashkët që është nënshkruar midis Institucionit dhe kandidatit të pranuar për studime, një kopje e së cilës është e depozituar edhe në dosjen e çdo specialisti. Të gjitha

Vera me Kleri
Atëri

DR. EDLIND PETA
[Signature]

Kriteri 11 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.

Kriteri 12 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specialistët fitues.

shpenzimet e tjera si literatura në bibliotekë, ajo online, vërtetimet apo leksione e materiale të tjera që u jepen specializantëve dhe që lidhen me programin e studimit, janë gratis dhe përballohen nga IAL. Studentët ishin të qartë dhe dakord me këtë zgjidhje. Edhe modalitetet e pagesës së tarifës së studimit ishin fleksibël dhe në dakordësi midis të dy palëve.

Mënyra e vlerësimit dhe procedura e kryer për t'u pranuar në këtë program studimi janë të qarta dhe të publikuara në rregulloren përkatëse, janë të aksesueshme nga kandidatët që duan të marrin pjesë në këtë konkurs dhe nga kushdo që ka interes rreth tij. Për rastin në fjalë ato janë publikuar sëbashku me njoftimin për zhvillimin e konkursit për hapjen e programit dhe kandidatet kanë patur informacionin dhe kohën e duhur për të marr pjesë në konkurim.

Në rregullore janë të përcaktuara qartë të gjitha modalitetet që lidhen me procedurat e aplikimit, të pjesëmarrjes dhe zhvillimit të konkursit, si dhe të vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në të. Gjithashtu ka informacion të rregullt mbi mënyrën dhe afatin e shpalljes së rezultateve dhe fituesve të atyre që pranohen për të vijuar këtë program studimi. Këto procedura të përcaktuara në rregullore u janë bërë me dije që në momentin e regjistrimit për të aplikuar për t'u regjistruar në program, përveç rregullores edhe me mjete të tjera të komunikimit. Ato u verifikuan në disa aplikant dhe rezultoi se për vitin akademik 2019-2020 këto procedura ishin të qarta dhe transparente për të gjithë kandidatet në konkurs. Rezultatet e konkursit rezultojnë të jenë bërë publike me disa mënyra komunikimi dhe janë afishuar në një vend të caktuar nga IAL, ku kanë patur akses që ti shikojnë kandidatët që kanë marr pjesë në konkurs dhe të gjithë të ineteresuarit e tjerë.

Rregullorja i ka të përcaktuara qartë të gjitha modalitetet e procesit të aplikimit dhe të konkurimit të kandidateve për të marr pjesë në këtë program studimi. Në të është e qarte edhe procedura e lidhjes së kontratës me fituesit e konkursit dhe që do të jenë specialistët e

Veronica Koci
[Signature]

[Signature]

	<p>ardhshëm. Kontrata me të cilën kandidatët janë njohur më parë, lexohet dhe një herë me kujdes dhe nënshkruhet nga të dy palët. Pas nënshkrimit të saj aplikanti konsiderohet përfundimisht fitues dhe fiton statusin e specializantit.</p>
<p>Standardi VII. 5- Në rregullore parashikohen plani i çdo programi specializues, frekuentimi i tyre, transferimet e studenteve.</p>	
<p>Kriteri 1 Plan i detajuar i çdo programi specializues, lëndët dhe praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyet, leja e lindjes, dhe mënyra e rikuperimit të mungesave duhet të jenë të parashikuara në rregulloren e specializimeve.</p> <p>Kriteri 2 Parashikohen procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.</p>	<p>Plani i studimit SPA në “ Kirurgji Orale “ është i detajuar në lëndë dhe module dhe ka pjesë shumë të rëndësishme të tij praktikat profesionale, që duhet të frekuentohen domosdoshmërisht nga specializantët dhe gjatë të cilave duhet të kryhen një numër i caktuar interventesh operatore që janë kusht i domosdoshëm për të kryer detyrimet përmbyllëse të programit dhe mbrojtjen e temës së Diplomës e diplomimin përfundimtar të specializantit. Programi është i organizuar në kurse të integruara në të cilat ka dhe module me përmbajtje teorike që zhvillohen përmes leksioneve e seminareve në auditor. Në kërkesat e rregullores janë të përcaktuara maksimumi i mungesave të lejuara, leja e lindjes dhe mënyra e rikuperimit të mungesave të cilat parashikohen në nenet 30,31,32,33,e 34 të Rregullores së programit të studimit, format e mësimdhënies në leksione dhe praktika klinike. Në planin mësimor janë paraqitur raportet e orëve për formim të përgjithshëm dhe për formimin specializues të kandidatëve.</p> <p>Programi i studimit SPA në Kirurgji Orale dhe Institucioni AU që e ofron atë, parashikon dhe e mundëson të drejtën e transferimit të studimeve në vite të ndërmjetme brenda ciklit të tretë, midis programeve të njëjta ose të ngjajshme të studimit brenda Institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publik ose jo publik, vendase ose të huaja. Ky institucion lejon transferimin e specializantëve të tij në shkolla të tjera të arsimit të lartë, shqiptar ose jo, sipas procedurave të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit të studimit SPA. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e këtij programi specializimi ose të ndonjë programi të</p>

Vera me Klaci
[Signature]

DA ERWIN PALLA
[Signature]

Kriteri 3 Parashikohen kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specialistit nga studimet specializuese.

Kriteri 4 Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues (për shembull institucionet jashtë vendit), kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovuës të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.

ngjashëm të kësaj fushe. Procedurat e transferimit të studimeve bëhen sipas rregullores së regjistrimeve dhe të transferimeve një kopje e të cilës është e administruar në Dosjen që ka paraqitur IAL, Albanian University.

Në rregulloren e këtij programi studimi janë parashikuar mënyra e pezullimit, zgjatja apo përjashtimi i specialistit nga ky program, kur kjo është e nevojshme. Specialisti i cili në fund të vitit akademik nuk ka realizuar 50% të krediteve, përfshirë edhe sesionin e vjeshtës, nuk e kalon vitin akademik, por mbetet në stazh. Specialisti detyrohet të frekuentojë lëndët përkatëse dhe të futet në provim në sesionin përkatës të radhës. Specialisti që ndjek këtë program studimi e fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit të studimit. Veprimet e specialistëve që bien në kundërshtim me rregulloren e programit të studimit si dhe me misionin e studimeve që parashikohet në program, janë të ndëshkueshme sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e përgjithëshme dhe në kodin e Etikës që janë pjesë e kësaj dosjeje.

Për raste kur konsiderohet e nevojshme apo me kërkesë të vetë specialistit kërkohet që një lënde apo modul ose një pjesë e specializimit, të kryhet në një institucion tjetër brenda ose jashtë vendit, rregullorja e këtij institucioni e bën të mundur një gjë të tillë. Një gjë e tillë në këtë IAL kryhet në kuader të bashkëpunimit me institucione të tjera, sidomos të atyre jashtë vendit. Modalitetet e këtij procesi si kohëzgjatja e kesaj periudhe si dhe njohja e krediteve të përfituara atje, bëhen me marrëveshje midis institucioneve dhe që janë të firmosura nga Rektori ose Dekani përkatës dhe titullari i Institucionit tjetër me të cilin ka bashkëpunim ky institucion. Të tilla marrëveshje ka disa me institucione brenda dhe jashtë vendit dhe ne patëm rast të verifikonim përmbajtjen dhe efektshmërinë e tyre.

Standardi VII. 6- Në rregullore parashikohet librezja e studentit, tipologia dhe mënyra e verbalizimit të

Naxhi Hoxhi

DA ERINDI PATA

rezultateve të provimeve.

Kriteri 1 Rregullorja parashikon formatin e librezës së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.

Kriteri 2 Përcaktohen tipologjia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të testimeve të kryera për pranimin e kandidateve, testimeve vjetore dhe testimit përfundimtar.

Në Albanian University, sipas rregullores së këtij institucioni, kandidatët janë të pajisur me librezën e specialistit e cila ka një format të miratuar, janë të parashikuara rregullat për ruajtjen dhe zëvendësimin e saj në rast humbjeje. Ajo ruhet nga specialisti deri në përfundim të programit të specializimit dhe përbën një dokument me rëndësi për dosjen e kandidatëve që vazhdojnë këtë program studimi. Janë të përcaktuara të gjitha rregullat e plotësimit të saj. Ajo plotësohet nga specialisti dhe nënshkruhet nga tutori klinik pas evidentimit të punimeve të kryera për çdo intervencë të kryer nga ana e specialistit.

Në rregulloren e programit të studimit dhe atë të institucionit janë të parashikuara qartë mënyra e kontrollit të dijeve me gojë dhe e verbalizimit të rezultateve gjatë gjithë procesit të studimit deri në përfundim të tij. Në të janë të përcaktuara edhe mënyra e testimit të kandidatëve që gjatë procesit të pranimit në këtë program, por edhe gjatë testimeve vjetore e atij përfundimtar në fund të procesit të specializimit. Rezultatet e provimeve të kryera për pranimin e kandidateve, shpallja e rezultateve bëhet në ambjentet e institucionit dhe në faqen zyrtare në internet. Testimet e mëvonshme që u bëhen specialistëve gjatë realizimit të programit të studimit dhe testimi përfundimtar i tij, rezultatet e tyre u bëhen të ditur kandidatëve nga sekretari i sekretarisë mësimore. Informacion lidhur me këtë problem të interesuarit kanë mundësinë të gjejnë edhe në adresën:

<https://albanian>

[university.edu.al/sq/datat-e-provimeve-sesioni-i-veres/](https://albanianuniversity.edu.al/sq/datat-e-provimeve-sesioni-i-veres/)

Standardi VII. 7- Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.

Kriteri 1 Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specialistëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit dhe argumentet që testohen.

Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 34 të saj, janë përcaktuar mënyra e vlerësimit të lëndëve gjatë provimeve për çdo vit specializimi. Kjo gjë bëhet sipas sistemit

Vexhimi Koci
[Signature]

[Signature]

Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e komisionit të testimit vjetor dhe të atij përfundimtar.

Kriteri 3 Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuara në testime dhe mënyra e rekuperimit të testimit në këto raste.

kombëtar të vlerësimeve me nota nga 4-10, ku nota 4 është jo kaluese, 5 është nota më e ulët kaluese, ndërsa 10 është nota maksimale e vlerësimit të njohurive. Ky vlerësim bëhet edhe sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve ECTS, ku vlerësimi më i ulët është E dhe më i lartë është A. Në këtë program studimi, modulet teorike vlerësohen me testim me shkrim, në përfundim të çdo semestri ku bëhet vlerësimi i njohurive të asaj pjese të programit. Në përfundim të çdo semestri bëhet edhe vlerësimi i shprehive praktike të fituara nga kandidati duke vlerësuar sasinë dhe cilësinë e ndërhyrjeve të kryera nga specialisti gjatë semestrit apo vitit akademik. Në këtë proces vlerësimi rolin kryesor e ka udhëheqësi i programit të studimit. Në këtë proces merret në konsideratë sasia e interveneteve të kryera, pozicioni i specialistit si operator primar, i dytë apo i tretë, teknika e operacionit dhe periudha postoperatorë etj. Në vlerësim bëjnë pjesë edhe sjellja e pozicionit etik të specialistit ndaj pacientit, kolëgeve dhe stafit me të cilin bashkepunon ai.

Vlerësimi i dijeve të specialistëve bëhet në çdo moment të punës e veprimtarisë mësimdhënëse e praktike të tyre dhe është një proces i vazhduar. Në këtë mënyrë zhvillohen pyetje e pergjigje, bashkëbisedime dhe testime gjatë praktikave ose seancave të kontrollit të dijeve në to. Komisioni i vlerësimit të dijeve në fund të modulit apo të lëndës propozohet nga drejtuesi i programit të specializimit dhe miratohet nga Dekani i FSHM. Si rregull në komision bëjnë pjesë pedagogu i lëndës a modulit dhe 1 ose 2 anëtar të tjerë që janë specialistë të fushës dhe kanë njohuritë e duhura rreth programit të zhvilluar.

Për të marr pjesë në testime në semester apo në fund të vitit akademik, specialisti duhet më parë të ketë shlyer detyrimet përkatëse të modulit apo lëndës për të cilën do të kryhet testimi. Në rregulloren e programit të studimit në nenin 34, pika 1, frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në

Vlora Koci
Albina

Dr. GJILJA PERA
Go

Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet formati i diplomës. Diploma duhet të firmoset nga rektori, kryetari i komisionit të provimit përfundimtar/final dhe dekani i fakultetit përkatës.

masën mbi 75%. Specializanti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit në një lëndë kur ka kryer më shumë se 25% mungesa gjatë zhvillimit të saj. Në rastet kur ka kryer deri në 50% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde, aëtherë është përcaktuar që të pranohet në sesionin e dytë. Nëse sasia e mungesave është më shumë se 50% të orëve që janë zhvilluar në atë lëndë, ai sipas rregullores shpallet përsëritës në atë lëndë. Mënyra e kontrollit të njohurive teorike dhe të shprehive praktike të fituara lidhur me studimet në lëndët teorike është e përcaktuar në programin e studimeve, konkretisht në syllabusin e çdo lëndë dhe kjo u bëhet me dije specializantëve që në fillim të lëndës apo modulit.

Në rregulloren e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale”, në nenet 45 e 47 të saj janë të përcaktuara modalitete dhe procedurat e mbrojtjes së Diplomës. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e përcatuara në rregulloren përkatëse kandidati që ka kryer këtë program studimi pajiset me Diplomë specializimi në “Kirurgji Orale”. Format i Diplomës është i miratuar në të dy varjantet që IAL ka paraqitur në dosjen përkatëse është shënuar se:

“...duke përfunduar studimet me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore...” student i ka fituar “Diplomë specializimi në “Kirurgji”/në “Kirurgji Orale”. Ky format diplome duhet të ndryshohet pasi në të gjithë dokumentacionin shoqëruar është theksuar se këtë program studimi e organizon Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe jo ai i Shkencave Shoqërore.

Standardi VII. 8- Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e specializantit.

Kriteri 1 Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specializanti.

Specializantët që ndjekin programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale” kanë detyra dhe të drejta si të gjithë studentët dhe specializantët e tjerë. Këto detyra dhe të drejta janë të përcaktuara qartë në statutin e institucionit (nenet 47,48 të tij), në rregulloren e përgjithshme të Institucionit (neni 57) dhe sidomos janë të saktësuar në Rregulloren e

Vezir Haxhi

DA SALVA PERA

Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specializantëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.

Kriteri 3 Në planin e programeve të specializimeve parashikohet se kur mund të kryhen veprimtari të caktuara të parashikuara nga këto programe, në ç'gradë autonomie mund të kryhen dhe çfarë aktivitete duhet të ketë kaluar me sukses specializanti për të zhvilluar disa aktivitete të tjera të parashikuara nga programi specializues, nën mbikqyrje ose në autonomi të plotë. Është përcaktuar një sistem vartësish të aktiviteteve të parashikuara.

Kriteri 4 Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specializantit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.

programit të studimit. Në nenin 44 të kësaj rregulloreje janë të përcaktuara hollësisht të drejtat dhe detyrimet e specializantëve në këtë program studimi.

Kërkesat e rregulloreve në këtë program studimi kanë të saktësuar nevojën dhe mënyrën e sigurimit të specializantëve gjatë kryerjes së studimeve. Kandidatët që janë regjistruar në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2019-2020, janë të siguruar tek Kompania e Sigurimeve EUROSIG, një kopje e modelit të policës së sigurimit nga ana e saj është në dosjen përkatëse.

Në planin e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve të veçanta të karakterit teorik apo të lëndëve të formimit karakterizues, janë theksuar vëllimi i problemeve që do të trajtohen dhe i njohurive që pritet të fitohen. Kontrolli i dijeve, përveç atyre që kryhen në fund të semestrit apo të vitit akademik, bëhet në çdo seance mësimore apo praktikë. Në këto kushte pedagogu është në gjëndje të përcaktoj shkallën e aftësisë së kandidatëve dhe kohën e aktivizimit të tyre në procedura klinike nga më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Duhet patur parasysh se në këtë program studimi marrin pjesë mjekë që janë të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve dhe janë të licensuar për të punuar në gojën e pacientit. Kjo do të thotë se ata i kanë të qarta shprehjet e punës në klinikë dhe në këtë program merren me modalitete e punës së specialistit. Kështu koha e qëndrimit të tyre si vëzhgues është relativisht e shkurtër, ata në një kohë të shpejtë kalojnë në veprimtari intensive klinike, sigurisht nën vëzhgimin e tutorit përkatës. Specializantëve u jepen për të trajtuar raste klinike të tipologjive të ndryshme dhe të një shkalle vështirësie që gjithashtu ndryshon nga rasti në rast, siç ndodh në praktiken reale klinike. Në gjithë këtë veprimtari ata monitorohen nga tutorët klinike dhe udhëheqësi i programit të specializimit.

Kohëzgjatja e programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale" është 4 vite akademike. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në këtë

Vera me Kerci
[Signature]

[Signature]

program është parashikuar të mos jetë më shumë se dyfishi i kohës normale për kryerjen e tij, pa marr parasysh kohën kur specialisti ka ndërprer studimet . Kjo është e parashikuar në këtë mënyrë në rregulloren e programit të studimit (neni 27, pika 4). Statusi i specialistit është i revokueshem sipas nenit 48 të po kësaj rregulloreje. Kjo mund të ndodhë në çdo kohë dhe në çdo rast kur konstatohen manipulim i të dhënave nga ana e kandidatit. Në këtë rast është përcaktuar se Dekani i njësisë kryesore që organizon programin e studimit i kërkon Senatit akademik të mbledhet menjëherë dhe të shqyrtoj rastin e konstatuar. Vendimi i Senatit diskutohet nga Këshilli i Etikës i AU i cili i propozon Rektorit të IAL-së revokimin e statusit të fituar nga kandidati. Rektori pasi e shqyrton rastin, merr vendim, të cilin ja dërgon senatit akademik dhe ky vendim zbatohet.

Konkluzionet e vlerësimit: Programi i studimit SPA në “Kirurgji Orale” i ofruar nga IAL Albanian University, përmban qëllim dhe objektiva të qarta të shprehura në dokumentacion dhe realisht në terren. Këto objektiva janë në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore të Arsimit të lartë Shqiptar dhe me synimet strategjike që ka ky institucion për zhvillimin e tij.

Departamenti i Stomatologji që ofron programin e studimit, përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi.

Programi i studimit disponon dokumentacionin e nevojshëm institucional dhe atë që lidhet me zhvillimin normal e të suksesshëm të tij.

Rregullorja e këtij programi studimi është hartuar sipas standarteve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe përmban të gjithë modalitetet e nevojshme për procedurat që ndiqen që në njoftimin për hapjen e këtij programi, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që duan të ndjekin atë, dokumentacioni i nevojshëm që paraqitet, procedurat e konkurimit, pranimit e regjistrimit në këtë program, detyrimet dhe të drejtat e specialistëve, detyrimet përmbyllëse, mbrojtja e tezës së diplomës e deri te akti i Diplomimit si Specialist në Kirurgji Orale.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik të SPA, raporti PAE/PAK, Personel akademik/Personel administrativ/student; shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i angazhaur në realizimin e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale” të ofruar Albanian University është përzgjedhur sipas kriterëve të nevojshme ligjore e didaktike, ka përvojë në mësimdhënie në shkollë të lartë, përbëhet nga personalitete vendas e të huaj, që kanë

Veronika Hoxha

Dr. Edlira Pano

tituj e grada shkencore dhe eksperiencë klinike të mjaftueshme për realizimin me sukses të programit. Drejtuesi i programit të studimit ka titullin Prof.Dr., Prof. Emeritus dhe Akademik. Personeli akademik ka në përbërjen e tij disa Prof.Dr., Prof.As.Dr., PhD apo Dr. të shkencave mjekësore. Ata kanë veprimtari të pasur kërkimore shkencore dhe veprimtari botuese brenda e jashtë vendit. Tutorët klinik të programit janë mjekë specialistë të fushës që i përket këtij programi dhe kanë një eksperiencë të pasur klinike e kërkimore shkencore në këtë fushë. Ata janë rekrutuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas kërkesave ligjore dhe rregulloreve të institucionit.

Në fillim të çdo viti akademik njësia bazë e këtij institucioni i paraqet Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore kërkesat për plotësimin e vendeve vakante në stafin akademik. Dekanati ia përcjellë ato Rektoratit i cili përcakton kriteret e pranimit sipas Rregullores së këtij Fakulteti që janë të përcaktuara në nenin 19, pika 3 të saj. Vendet e punës në këtë institucion përfitohen sipas procedurave konkurruese. Kandidati që fiton duhet të kalojë një periudhë prove prej 3 muajsh, pas të cilës kur nuk ka probleme lidhen marrëdhënie pune me kontratë të rregullt sipas ligjit. Kontratat e punës janë të hartuara sipas kërkesave të kodit të punës dhe të ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Ato janë të një formati të caktuar për PAE dhe për PAK.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelën 3)

Stafi mësimdhënës për Programin e studimit SPA në Kirurgji Orale përbëhet nga Personel Akademik efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), si edhe Personel akademik i Ftuar. Marrin pjesë në realizimin e këtij Programi si PAE 24 pedagogë të ndarë si më poshtë: 5 kanë Prof. Dr., nga të cilët 2 janë me kombësi italiane dhe titujt i kanë ftuar atje, 2 janë Prof.As.Dr., 12 janë me PhD/Dr., 5 janë me SPA në fushën e Kirurgjisë orale e Maksilo Faciale.

Si PAK në këtë program studimi marrin pjesë 17 pedagogë, të cilët kanë këtë përbërje: 6 janë Prof. Dr. nga të cilët 2 janë ish-punonjës të Universiteteve italiane, 5 Prof. As. Dr., 2 PhD, 3 Doktor dhe 1 është me SPA. Në këto rrethana kur në vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar 35 specialistë, zhvillimi normal i programit të studimit në SPA Kirurgji Orale mund të konsiderohet se i ka premisat të realizohet me sukses.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelën 4)

Sipas të dhënave që ka paraqitur IAL, një pjesë e konsiderueshme e Personelit Akademik që marrin pjesë në zhvillimin e këtij programi janë pedagogë të ftuar nga universitetet e huaja, prej të cilëve 2 janë Prof. Dr. dhe janë PAE. Ata janë gjithsej 6 pedagogë që mbajnë tituj shkencor si më poshtë: 4 janë Prof. Dr., dhe 2 janë me PhD, të cilët janë të gjithë specialist në Kirurgji Orale. Ndërsa pedagogët shqiptar janë si më poshtë: 1 Akademik, 5 Prof. Dr. dhe 6 SPA.

- Të dhëna sipas moshës (shih Tabelën 5)

Duke analizuar personelin akademik sipas moshës rezulton se janë të moshës 36-45 vjeç 20 PAE dhe 4 PAK. Ata kanë formim shkencor 2 janë Prof.As.Dr., 13 janë me PhD dhe Doktorë dhe 5 janë pa tituj. Në moshën 46-55 vjeç janë 1 PAE dhe 5 PAK nga të cilët 2 janë Prof.Dr., 1 Prof.As. dhe 2 PhD. Janë të moshës 56-65 vjeç 4 PAE (1 Prof.Dr., 1 Prof.As., dhe 2 PhD) dhe 5 PAK (2 Prof.Dr., dhe 3 Prof.As.). Në përbërje të stafit akademik ka edhe 3 PAE dhe 2 PAK mbi 65 vjeç që mbajnë titullin Prof. Dr. dhe që janë brenda kriterëve ligjore për të dhënë mësim në fushën e tyre.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Vasmi Kaci
Albino


Dr. Erion Pasa
Pa

Personeli akademik i aktivizuar për realizimin e programit është i pajisur me kontrata pune të lidhura sipas ligjit. Për PAE kontratat janë të lidhura pa afat, ndërsa për PAK ka të lidhura kontrata me afat të përcaktuar, por me të drejtë përsëritjeje. Në përbërje të stafit akademik ka edhe pedagoge të ftuar, marrdhëniet me të cilët rregullohen sipas marrëveshjeve që ka me institucionin përkatës, të cilat janë të lidhura sipas kërkesave të ligjit dhe janë efektive.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara	
<p>Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kritereve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë së 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p>	<p>Kurikula e Programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale” si dhe emërtimi saj kanë pësuar ndryshime për t’u përshtatur me kërkesat e ligjit në fuqi dhe të akteve nënligjore që burojnë prej tij dhe që përshtaten e aktualizohen në vazhdimësi. Në këtë program studimi janë bërë ndryshime lidhur me emërtimin dhe kohëzgjatjen e tij, sipas Urdherit të Ministrit të MASH me Nr. 75, datë 18.02.2013. Kjo kurrikule studimi është riorganizuar përsëri me vendim të Senatit Akademik Nr.5, datë 28.02.2018, mbi masën 20% dhe është aprovuar ky ndryshim nga MASR me Urdhër të Ministrit Nr.514, datë 24.10.2019. Për të gjitha ndryshimet e bëra janë informuar sipas procedurave e afateve ligjore Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit Shkencës dhe Rinisë.</p> <p>AU ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, personel akademik dhe ndihmës akademik për realizimin e plotë dhe pa pengesa të programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale”. Me personelin që është agazhuar në realizimin e programit dhe me infrastrukturën mbështetëse që është siguruar në këtë IAL, janë mundësitë që të realizohen objektivat dhe të arrihet qëllimi i këtij programi për të përgatitur Kirurgë Oral, të aftë profesionalisht e me formim shkencor sipas kërkesave të kohës kryesisht për shërbimin shëndetësor shqiptar, por dhe më gjerë. Po kështu personeli ndihmës administrativ dhe strukturat dytësore në shërbim të programit, plotësojnë kërkesat e programit dhe mundësojnë realizimin e tij sipas parashikimeve të bëra.</p>

Vezir me Rexhep


Dr. GJILIN PETA


Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.

Albanian University është i organizuar sipas kërkesave të ligjit “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” që mban Nr.80/2015 dhe të gjithë akteve që burojnë në zbatim të tij. Strukturat organizative, njësitë kryesore dhe ato bazë që realizojnë procesin mësimor dhe kërkimin shkencor janë të organizuara sipas kërkesave të ligjit dhe po ashtu të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm si statuti i Institucionit dhe rregulloret përkatëse deri tek rregulloret e veçanta për programe studimi siç është ai i SPA në Kirurgji Orale. Ky institucion disponon edhe struktura dytësore të organizuara siç është Klinika Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”, një institucion i pajisur me kapacitetet e nevojshme infrastrukturore dhe i licensuar sipas kërkesave të ligjit përkatës. Veprimtaria e kësaj klinike të nivelit Universitar organizohet e funksionon sipas rregulloreve përkatëse të klinikës. Në rregulloret përkatëse janë të përcaktuara detyrat dhe roli i personelit administrativ dhe atij akademik që kanë funksione të përcaktuara dhe zotërojnë shkallë kualifikimi dhe mbajnë tituj e grada shkencore sipas rolit të parashikuar në rregullore.

Standardi III. 3 - Rrjeti formues¹ plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

Kriteri 1 Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.

IAL dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore që ofron këtë program studimi, plotëson kriteret e nevojshme të përgjithshme që janë të parashikuara për sa i përket rrjetit formues që lidhet me programin e studimit SPA në Kirurgji Orale. Në dispozicion të këtij programi është vënë Klinika Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”, që është një institucion i organizuar në reparte dhe funksionon sipas rregulloreve së posaçme të saj si institucion. Kjo klinike ofron për programin e studimit në fjalë të gjitha facilitetet e nevojshme dhe mendojmë se plotëson kushte për zhvillimin me sukses të tij në mënyrë optimale. Duke qënë një institucion i organizuar me reparte ku zhvillohet aktiviteti mjekësor sipas nënspecialiteteve përkatëse, kjo

¹ Me rrjet formues nënkuptohet bashkësia e të gjitha strukturave të përfshira në aktivitetet e parashikuara për secilin program specializues: strukturat qendrore/bazë, dytësore dhe komplementare.

Vaxhai Hoxhi

Dr. Erland Palla

Kriteri 2 Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.

Kriteri 3 Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kritereve të mëposhtme:

- a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme
- b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional
- c. Burime financiare të mjaftueshme
- d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë
- e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale
- f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues
- g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve
- h. Efikasiteti dhe efënca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.

klinikë ofron për programin e studimit SPA në Kirurgji Orale, një repart filtri e ekzaminimi, radiologjie, salla operatore për Kirurgji e implantologji, si dhe ka një repart ditor "Day Hospital". Për implementimin e këtij programi ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me Qëndrën Universitare të traumës dhe spitalin Salus.

AU plotëson kërkesat minimale specifike për çdo specialitet që janë të parashikuara në shtojcën nr.2 lidhur me rrjetin formues të tij. Puna është e organizuar në reparte sipas veçorive karakteristike të çdo nënspecialiteti. Rrjeti formues i këtij institucioni, që lidhet me realizimin me sukses të këtij programi SPA plotëson standartet dhe kriteret specifike sipas kërkesave të programeve të studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe konkretisht në fushën e Kirurgjisë Orale. Ky institucion me një përvojë 15 vjeçare në fushën e Arsimit të lartë në të tre ciklet e studimit ka dokumentacion të plotë, infrastukturën e nevojshme dhe përvojën e duhur për realizimin e plotë të programit të studimit SPA në Kirurgji Orale.

AU ka organizuar dhe plotëson kërkesat e përgjithshme dhe ato specifike lidhur me kriteret e këtij programi studimi në SPA.

a) Pajisjet e mjediseve mësimore e ato të praktikave profesionale janë të përshtatshme, të plota e të mirëmbajtura dhe krijojnë kushtet për një mësimdhënie normale e të kohës. Kjo krijon premiset e duhura për realizimin pa pengesa të këtij programi. Në funksion të këtij programi studimi sallat janë të pajisura me video projektorë dhe ka lidhje me internet Wireless. Në këtë institucion është ngarkuar një specialist i profilit IT, i cili është gjithnjë në gatishmëri të mirëmbajtjes së aparaturave dhe të rrjetit kompjuterik të programit të studimit.


b) Ky program studimi mbështetet mbi një infrastrukture të kompletuar që mundëson formimin teorik sipas standarteve të kërkuara, por dhe një mundësi praktike reale për të kryer intervente të tipeve të ndryshme, por dhe që kanë shkallë vështirësie klinike të ndryshme që varion sipas rastit të paraqitur. Egzistenca e një numri të

Vox mi Horci
Albin

DA ERALIA PELLA
Albin

	<p>interventeve operatore që kontrollohet dhe monitorohet vazhdimisht, edhe pse në kushtet specifike të pandemisë Covid-19 konsiderohet e mjaftueshme për një formim profesional të arsyeshëm nga ana e specialistëve. Regjistrat e sallave operatore dhe kartelat klinike të pacientëve që u vëzhguan si dhe librezat personale të specialistëve japin informacion dhe vërtetojnë se është kryer një numër i mjaftueshëm ndërhyrjesh operatore që bën të mundur zotërimin e protokollit dhe teknikës operatore për çdo rast.</p> <p>c) Programi i studimeve zotëron të ardhura financiare të mjaftueshme. Ato sigurohen jo vetëm nga tarifat e specialistëve, por edhe nga tarifat që merren nga shërbimi ndaj të tretëve.</p> <p>d) Tutorët e praktika apo Udhëheqesi i Programit, janë mjekë të specializuar në fushën e Kirurgjisë Orale dhe mbajnë tituj dhe grada shkencore. Ata kanë eksperiencë të mjaftueshme klinike që të përballojnë kërkesat e këtij programi dhe të mundësojnë realizimin cilësor të tij.</p> <p>e) Struktura organizative e AU e cila është ngarkuar me implementimin e këtij Programi SPA është e plotë si nga ana akademike ashtu edhe ajo administrative. IAL ka paraqitur dokumentacion të plotë lidhur me përbërjen e tyre, mënyren e rekrutimit të stafit, përgatitjen e dokumentacionit dhe krijimin e dosjeve personale. Në të gjitha rastet e verifikuara gjatë vizitës në institucion nuk u gjetën mungesa në këtë drejtim. Kapacitetet njerëzore të ngarkuara me këtë proces janë të mjaftueshme, sidomos po të marrim parasysh numrin e studentëve që frekuentojnë aktualisht këtë program.</p> <p>f) Programi i studimeve SPA është hartuar duke parashikuar aktivitete orientuese që mundësojnë përgatitjen cilësore profesionale të kandidateve dhe merr në konsideratë nevojat e tregut të punës në këtë fushë. Aktiviteti profesional që e shoqëron këtë program studimi përputhet mirë me nevojshmërinë e specialistëve të Kirurgjisë në këtë fushë që kërkon dije bashkëkohore dhe njohje të protolloleve të ndërhyrjeve operatore</p>
--	--

Veronika Koci


DA GRUPOVA


Kriteri 4 Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë, dytësore, etj) dhe konvencionet eventuale me këto struktura dhe me ato komplementare.

Kriteri 5 Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

dhe të teknologjive të stadi aktual.

g) Seleksionimi dhe përzgjedhja e specialistëve bëhet sipas procedurave të hartuara qartë e zbatuara pa u shmangur prej tyre. Të gjitha këto janë të përcaktuara në dokumentacionin e IAL dhe në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i aktivitetit klinik të kandidateve gjatë kryerjes së këtij programi është realizuar në dokumentacion dhe monitorohet në çdo ditë mësimi apo praktike profesionale. Çdo rast që paraqitet dhe do të merret në mjekim përbën një mundësi diskutimi nga të gjithë pjesmarrësit dhe ushqen një debat profesional që u shërben të gjithë specialistëve. Të gjitha këto shoqerohen edhe me testim me shkrim në fund të modulit apo të lëndës dhe janë pjesë e vlerësimit vjetor të kandidatëve.

h) Konsiderohet pjesë e veçantë e këtij programi studimi edhe aktivizimi i specialistëve në proceset e studimeve që organizohen në vijimësi, hartimi i temave e materialeve me përmbajtje shkencore. Specialistët janë aktivizuar në konferenca e sesione shkencore dhe janë stimuluar që të përgatisin materialet e tyre dhe të referojnë në to. Disa prej tyre i kanë prezantuar ato edhe në aktivitete shkencore jashtë vendit.

Albanian University, disponon gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon praninë dhe statusin e rrjetit formues të programit të studimit në SPA për "Kirurgji Orale". Ky dokumentacion është i arkivuar dhe i aksesueshem nga të interesuarit. Ai vërteton jo vetëm praninë dhe statusin e strukturave institucionale, por edhe ato të atyre bashkëvepruese për pjesën me të cilën ka marrëveshje institucionale dhe që janë në dispozicion të këtij programi studimi. Të tilla institucione janë Qendra Spitalore Universitare, Qendra e Traumës, Spitali Salus dhe disa struktura private të shërbimit stomatologjik që kryejnë aktivitet kirurgjokal. Të gjitha këto janë resurse në dispozicion të procesit të Specializimit të kandidatëve në këtë program SPA.

Veronica Kuci
[Signature]

DA ERALIN PELA
[Signature]

Kriteri 6 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specialistëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.

Kriteri 7 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specialistëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 8 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specialistëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 9 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial kompleksiv vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specialistët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).

Të gjitha strukturat e ngarkuara për implementimin e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale”, ato qëndrore apo dytësore, janë të akredituara nga MASH/APAAL (ASCAL) në bashkëpunim me MSH dhe Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve shëndetësore. Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Albanian University e ka akredituar me Vendim të BA Nr.01, datë 24.01.2020, këtë program studimi në SPA për “Kirurgji Orale”. Ky zhvillohet pranë një programi universitar siç është ai i studimeve të integruara për ‘Master i shkencave në Stomatologji’, i cili është i akredituar me vendim Nr. 88, datë 21.09.2017.

Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm me të cilin provon ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme mjekësore e stomatologjike me karakter diagnostikues e mjekues që janë në funksion të këtij programi studimi. Këto shërbime të përgjithshme diagnostikuese që janë të pranishme në klinikën stomatologjike “Çerçiz Mingomataj” si institucion ndihmës në zhvillimin e këtij programi studimi, janë pjesë e rrjetit formues të specialistëve që ndjekin këtë program. Ato janë konform kërkesave të parashikuara në shtojcën nr.2 për akreditimin e strukturave.

IAL disponon dokumentacionin e nevojshëm që vërteton ekzistencën e specialiteteve të ngjajshme në strukturat e veta që janë pjesë e rrjetit formues të këtij programi studimi. Në Klinikën Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj” pjesë e strukturave ndihmëse të AU në implementimin e këtij programi SPA, shërbimi stomatologjik është i organizuar sipas profileve dhe janë në funksion të gjithë specialitet e stomatologjisë që njihen në vendin tonë dhe në Europë. Në këtë kuadër është i organizuar edhe shërbimi i Kirurgjisë Stomatologjike me aksesoret e vet, pranë të cilit është organizuar Programi SPA në “Kirurgji Orale”.

Institucioni disponon dokumentacion të plotë mbi numrin e shërbimeve që ofron për ushtrimin e specialistëve që marrin pjesë në këtë

Vera ...

DA ...

	<p>program studimi. Në Klinikën Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj” që ka statusin e një klinike universitare dhe është institucion shëndetësor i akredituar, institucion ndihmës në zhvillimin e programit SPA, shërbimi është i organizuar: 1. Punkti i filtrit dhe Ekzaminimit, 2. Radiologjia, 3. Receptsi, 4. Salla 1 ku kryhet shërbimi i terapisë. 5. Salla 2 ku kryhet shërbimi i protetikës stomatologjike. 6. Salla 3 e Priodontologjisë. 7. Salla 4, Terapi, 8. Salla 5 ku kryhet shërbimi i Ortodontisë. 9. Salla 6 ku janë vendosur shërbimi i Kirurgjisë, Implantologjisë dhe Day Hospital. Të gjitha këto janë sipas parametrave që parashikon shtojca nr.2.</p> <p>Ky institucion i Arsimit të lartë dhe strukturat e tij shëndetësore që janë ndihmëse e programit të studimit SPA në Kirurgji Orale, disponon dokumentacion të rregullt mjekësor me të cilin vërteton aktivitetin e tij vjetor, të përfshira në rrjetin formues në disozicion të këtij programi. Në dosjen e paraqitur për vlerësim të programit, institucioni ka paraqitur një pasyrë të aktivitetit të Klinikës Stomatologjike të AU nga viti 2006 deri në vitin 2020 në formën e një studimi përmbledhës. Të tillë dokumentacion disponon për çdo vit akademik edhe gjatë kohës që po realizohet ky program studimi. Një pjesë e këtij aktiviteti është kryer nga specialistët e programit SPA në Kirurgji Orale, por aktiviteti i specialistëve në këtë veprimtari është më i vogël se 30% të atij që është kryer nga vetë institucioni.</p>
<p>Standardi III. 4- Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon burime njerëzore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e programeve specializuese.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara.</p> <p>Kriteri 2 Çdo program specializues përcakton:</p>	<p>Albanian University disponon dokumentacionin e nevojshëm me të cilin provon dhe përshkruan ndërtimin e strukturave organizative që funksionojnë për realizimin e këtij programi SPA. Në këtë dokumentacion ka të dhëna të plota për personelin akademik dhe administrativ që implementon këtë program studimi, figurat drejtuese e udhëheqese të tij si dhe figurat profesionale në funksion të këtij programi të ciklit të tretë. Të gjitha këto u verifikuan, posedohen në dosjet përkatëse dhe ruhen në</p>

Verësi i Kërkimit
Albin

Dr. ERLEN PETA
[Signature]

a. Një figurë drejtuese, përgjegjësi i programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

b. Këshilli i profesorëve përveç përgjegjësit të programit të specializimit, përcakton një këshill drejtues të programit të studimit i cili, në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.

c. Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative.

d. Të paktën një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm.

Zyrën e burimeve njerëzore të FSHM të AU.

Ky program studimi SPA në "Kirurgji Orale" i ofruar nga Albanian University i ka të përcaktuara dhe ruan dokumentacion të plotë për:

a) Figura drejtuese e këtij programi të ciklit të tretë është Akademik, Prof. Emeritus, Prof.Dr. CV dhe aktiviteti i tij akademik e shkencor janë të njohura brënda e jashtë vendit dhe të pasqyruara në dokumentacionin e Institucionit. Përgjegjësi i programit të studimit ka titullin Prof.As. dhe eksperiencë profesionale në fushën e kirurgjisë orale mbi 10 vjet. Këshilli drejtues i këtij programi studimi SPA, përbëhet nga 5 antëarë, të cilët janë ekspertë të njohur të kirurgjisë dhe profesorë të njohur në fushën e specializimeve afatgjata në Stomatologji.

b) Organizatorët e programit të studimit në "Kirurgji Orale", së bashku me Udhëheqësin e programit, kanë punuar për të mundësuar dhe realizuar një program studimi që bën të mundur formimin profesional të një mjeku specialist me dije e formim bashkëkohor.

c) Për administrimin dhe menaxhimin e komponentit financiar të këtij programi studimi është ngarkuar zyra e financës e AU. Ajo ka bërë përmbushjen e kërkesave administrative që lidhen me realizimin e programit dhe ka hartuar bilancin e institucionit dhe të këtij programi çdo vit.

d) IAL ka ngritur Njesinë e Sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila ka realizuar në mënyrë periodike monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë me anë të metodave që janë përcaktuar në rregulloren përkatëse të këtij formacioni. Ajo ka hartuar pyetësorë që u adresohen studentëve nëpërmjet një formati elektronik cili ruan anonimatin dhe pas plotësimit i nënshtrohet një përpunimi e analize nga ku nxirren përfundime. Metoda të tilla janë realizuar edhe me grupet e sigurimit të cilësisë që janë ngritur në rang Departamenti.

STANDARDI IV - PERSONELI AKADEMIK, SHËNDËTËSOR, NDIHMËS MËSIMOR-SHKENCOR, ADMINISTRATIV DHE TUTORËT JANË TË MJAFTUESHËM DHE PLOTËSOJNË STANDARDET E PËRGJITHSHME SI DHE ATO SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR ÇDO

Vera me Korsi
Shërbim

DR. ERLENDA PETLA
[Signature]

SPECIALITET**Standardi IV. 1 - Personeli i angazhuar në programet specializuese plotëson standardet e parashikuara**

Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues.

Kriteri 2 Institucioni disponon personel akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas specifikimeve në shtojcën 2.

- a. Pedagogë universitarë: profesorë, profesorë të asociuar dhe docentë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm është nga sektori disiplinor i programit të specializimit që ofrohet nga institucioni.
- b. Pedagogë jo universitarë që ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues: personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve dhe me të cilët është lidhur një kontratë me kohëzgjatje të paktën sa kohëzgjatja e secilit program specializues.
- c. Pedagogë të jashtëm me kontratë: ekspertë të sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.

Kriteri 3 Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këto programe përbën një garanci për realizimin e programeve (50% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, të angazhuar në punën klinike dhe me tituj

IAL që ka organizuar këtë program studimi SPA, diponon dokumentacionin e nevojshëm për personelin akademik dhe atë administrativ që merret me zbatimin e këtij programi. Në të janë të përfshira dhe figurat didaktike dhe ato profesionale, si dhe personat përgjegjës që janë të angazhura me realizimin e këtij programi specializues.


Ky IAL që ka organizuar këtë program SPA, disponon personelin e nevojshëm akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas kërkesave për kriteret akademike e shkencore që duhet të plotësojnë ata, dhe i përmbush nevojat e veta për këtë program sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr.2 lidhur me këtë problem.


a) Personeli akademik i përfshirë në realizimin e këtij programi për vitin akademik 2019-2020, janë pedagogë me kohë të plotë në masën rreth 60%, ndësa 40% janë PAK. Të gjithë pedagogët zotërojnë tituj e grada shkencore në lëndët e specialitetit janë 4 Prof. Dr., 3 prof. AS dhe 2 PhD.

b) Në realizimin e këtij programi studimi nuk marrin pjesë pedagogë jo universitar. Të gjitha lëndët teorike dhe praktikat profesionale që zhvillohen gjatë këtij programi studimi në Klinikën Stomatologjike të AU janë dhe pjesë e stafit akademik të tij.

c) Pedagogë të jashtëm për realizimin e këtij programi studimi, janë marr me kontratë nga Universitete të huaja, zotërojnë CV të plotë dhe kapacitet profesional të lartë dhe marrëdhëniet me ta janë rregulluar në bazë të marrëveshjeve që janë lidhur midis institucioneve.

Ky program studimi SPA në Kirurgji Orale, që ka organizuar AU, realizohet nga profesorë shqiptarë dhe të huaj që janë specialist të spikatur në fushën e Kirurgjisë. Ata kanë sjell në këtë program teknika të reja të trajtimit në fushën e Kirurgjisë Orale. Ky staf pedagogësh përbëhet

Vezmi Koci


DA ERIND PALLA


<p>akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.</p> <p>Kriteri 4 Numri i studentëve që mund të ndiqet nga një tutor është jo më i madh se 3 (tre).</p>	<p>nga profesorë të Universiteteve italiane dhe kanë sjell këtë eksperiencën e tyre të pasur. Veprimtaria e profesorëve shqiptar e të huaj është e pasur si në fushën e praktikës klinike ashtu edhe në mësimdhënie dhe në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe atë botuese. Kjo është një risi e këtij programi studimi.</p> <p>Numri studentëve që ndiqen nga 1 tutor në këtë program studimi është nga 1-3 dhe kjo është brenda standarteve të Akreditimit për programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjëksisë.</p>
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit dhe detyrave që u janë caktuar.</p>	<p>AU në fillim të çdo viti akademik, si dhe në muajin dhjetor, kur kjo është e nevojshme, paraqet nevojat për personel akademik. Departamenti i Stomatologjisë i ka paraqitur për rastin e këtij programi SPA në “Kirurgji Orale” nevojat e tij për plotësimin e vendeve vakante që lidhen me zhvillimin e programit. Dekanati i FSHM ia ka përcjell këto nevoja Rektoratit të Universitetit, i cili ka përcaktuar kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurimit dhe që është kryer pranë njësisë baze, Departamentit përkatës. Të gjitha procedurat për këtë proces janë kryer në përputhje me kërkesat e Statutit të IAL dhe me rregulloren e FSHM, sipas nenit 19, pika 3 e tij. Vendet e punës në këtë institucion fitohen përmes procedurave konkurruese dhe kjo mënyre ka funksionuar edhe për programin SPA që po analizojmë.</p> <p>IAL, Albanian University ka ndjekur procedura të rregullta ligjore dhe transparencë në rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik për programin e studimit SPA. Vlerësimet për punën e pedagogëve bëhen nga ana e institucionit dhe e strukturave përkatëse të ngarkuara për këtë problem. Por ato janë kryer edhe nga ana e specialistëve që vijojnë këtë program studimi. Për këtë funksionojnë metodat e anketimeve anonime dhe fokus grupe të organizuara nga NJSBC. Një praktikë e tillë është paraqitur në dokumentacion dhe i përket shkresës nr.169, date 03.03.2020. Nga verifikimi ynë në anketat</p>

V. ...

M. ...

<p>Kriteri 3 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>anonime të specializantëve, rezulton se ka vlerësime objektive mbi punën e pedagogëve. Njëri prej specialistëve italian kishte marrë unanimisht vlerësimin maksimal si specialist me aftësi të larta në fushën e Kirurgjisë Orale.</p> <p>Në AU, të gjitha të dhënat që lidhen me procesin e përzgjedhjes dhe të rekrutimit të personelit akademik janë të ruajtura pranë zyrës së burimeve njerëzore. Edhe dokumentacioni i mëtejshëm që sigurohet gjatë veprimtarisë pedagogjike e shkencore të PAE dhe të PAK janë ruajtur në dosjet përkatëse të tyre dhe administrohen nga ana e institucionit sipas kërkesave ligjore për këtë problem.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, që ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj ka kryer së paku pesë vjet studime në një institucion të huaj në të njëjtën gjuhë mësimdhënieje, ose disponon një certifikatë për njohje të avancuar të gjuhës së mësimdhënieje të njohur ndërkombëtarisht në nivelin C1, dhe ka kryer së paku një vit studime në një institucion me të njëjtën</p>	<p>Në programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale”, që ka organizuar IAL, AU, një pjesë e konsiderueshme e stafit janë të ftuar nga universitetet e huaja, kryesisht ata italiane. Për rrjedhojë një pjesë e leksioneve dhe e praktikave profesionale zhvillohen në këtë gjuhë. Kjo është një risi e këtij programi. Megjithatë edhe në këtë rast plotësohen të njëjtat standarde, si ato që janë përcaktuar kur programi zhvillohet në gjuhë shqipe. Nga ana jonë u kërkua me insistim nëse kjo përbënte ndonjë vështirësi për specializantët. Nga ana e tyre kjo u konsiderua si një anë mjaft pozitive e programit për faktin se një mënyrë e tillë për ta nuk paraqet ndonjë vështirësi, pasi që në kushtet e pranimit kanë patur detyrimin që të zotërojnë një nga gjuhët kryesore të Europës dhe shumica e tyre kanë zgjedhur si gjuhë të huaj të parë italishten. Së dyti specializantët e vlerësuan këtë edhe për faktin se në mënyrë graduale i përgatit ata edhe me mënyrën e të studjuarit e të shkruarit në këtë gjuhë dhe i ndihmon që të jenë të aftë të prezantojnë materiale shkencore në gjuhë të huaj. Megjithatë eksperti i huaj që është diplomuar në një Universitet italian, insiston se në këtë rast duhet të njihet në një nivel shumë të lartë gjuha italiane, përndryshe është e vështirë të kuptohen pedagogët italianë kur flasin për shkencë.</p>

Vaxmi Koci

[Signature]

gjuhë mësimdhënieje,

Kriteri 3 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka mbajtur mbi 10 kumtesa shkencore në këtë gjuhë.

Personeli akademik i universiteteve të huaja që jep mësim në këtë IAL, e zhvillon atë në gjuhë të huaj. Megjithëse specialistët e njohin atë dhe zotërojnë certifikatën përkatëse, institucioni ka vendosur edhe përkthyes të kësaj gjuhe, të cilët janë specialist të fushës, por që zotërojnë gjuhën e huaj në nivelin e kërkuar. Pedagogët shqiptar që japin mësim në këtë institucion, japin mësim në gjuhën shqipe siç është i licensuar ky program studimi. Por në takimet që patëm, të gjithë pedagogët zotëronin gjuhën e huaj në nivelin C1 dhe bisedat tona u zhvilluan normalisht në të dyja gjuhët, pa patur asnjë vështirësi. Specialistët tanë zotërojnë certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj dhe kanë disa vite që punojnë me ata të huaj bashkërisht dhe komunikojnë lehtësisht me ta. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultonte se në shumicë kishin certifikatë për gjuhët italiane e angleze, por edhe në disa gjuhe të tjera të Europës, pasi disa syresh janë diplomuar jashtë.

Personeli akademik shqiptar që jep mësim në këtë program specializimi e zhvillon atë në gjuhën shqipe. Por ai ka bashkëpunuar ngushtësisht me pedagogët e huaj dhe gjuha nuk përbën ndonjë kufi ndareës midis tyre. Një pjesë e personelit akademik të aktivizuar në këtë program ka studjuar jashtë, disa në universitete italiane. Në të gjitha aktivitetet shkencore ndërkombëtare, pedagogët tanë kanë paraqitur materiale në gjuhë të huaj, sidomos në italisht dhe në anglisht.

Edhe marrdhëniet e bashkëpunimit që janë lidhur midis këtij institucioni dhe Universiteteve të huaja, parashikojnë dhënien e leksioneve reciprokisht në institucionet bashkëvepruese, pra të pedagogeve shqiptar në gjuhë të huaj, të cilën jo vetëm me dokument, por u pa se ata e zotërojnë mirë dhe janë të familjarizuar me të.

Standardi IV. 4- Specialisti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.

Vera mi Koci
Mirë

DA ERALIN PELA
[Signature]

Kriteri 1 Studenti ka një udhëheqes klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka gradën "Doktor".

Kriteri 2 Studentit që ka një udhëheqës klinik që nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet dhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik të institucionit me së paku gradën shkencore "Doktor" apo "PhD" (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.

Kriteri 3 Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.

Kriteri 4 Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.

Specializantët që ndjekin programin e studimit SPA në Kirurgji Orale, kanë udhëheqës të praktikave profesionale në një grup ku bëjnë pjesë 1-3 veta. Tutorët e këtij programi studimi janë mjekë të specializuar të fushës së Kirurgjisë, të diplomuar brenda ose jashtë vendit dhe kanë eksperiencë mbi 10 vjeçare, disa me dekada. Tutorët janë përcaktuar sipas kërkesave të rregullores së programit të studimit, bazuar në nenin 44, pika 4 e tij, ku përcaktohet se ata duhet të jenë kirurg oral. Një pjesë e tyre plotëson kërkesat e rregullores dhe të këtij standarti, por përveç kësaj, janë diplomuar në Kirurgji orale në AU. Ky është një motiv më tepër për ata që ndjekin programin e studimit SPA në këtë institucion.

Përveç tutorëve që drejtojnë praktikat profesionale për çdo specializant, IAL ka vënë në dispozicion të tyre dhe një Udhëheqës që është pjesëtar i stafit akademik, specializuar në Kirurgji Orale dhe që mban titullin shkencor Pro.As. Fusha e specializimit të tutorëve dhe të Udhëheqësit të këtij programi SPA, është konform rregullores së programit dhe standartit të kërkuar. Ata janë specialist në Kirurgji Orale, të diplomuar brenda ose jashtë vendit. Ka prej tyre edhe nga ata që janë diplomuar në këtë institucion, por që plotësojnë kriteret e nevojshme për detyrën që kryejnë.

Këshilli drejtues i këtij programi studimi ka zgjedhur për këtë program studimi udhëheqes klinik të aftë për të drejtuar veprimtarinë klinike profesionale të specializantëve. Ata janë përzgjedhur edhe me synimin që të jenë të aftë për të iniciuar e drejtuar punën kërkimore shkencore të specializantëve. Për këtë arsye ata janë përzgjedhur midis atyre që kanë rezultate të spikatura në veprimtarinë klinike e operatore të kirurgëve, por edhe në veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore, atë referuese e botuese brenda e jashtë vendit në fushën e Kirurgjisë Orale.

Në këtë program studimi të ciklit të tretë , SPA në Kirurgji Orale, IAL ka zgjedhur tutorë të cilët janë të punësuar si pjesë e stafit ajkademik, si

Voxma Hoxhi

Dr. Edlira Pasha

Kriteri 5 Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.

Kriteri 6 Udhëheqësi klinik i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës klinike të studentit.

pjesë e strukturave ndihmëse e rrjetit formues të tij. Ka edhe bashkëpunëtor të marr nga institucione arsimore dhe klinike jashtë vendit, të cilët plotësojnë kriteret e standartit të kërkuar, janë specialistë në Kirurgji Orale, kanë eksperiencë të gjatë klinike e shkencore dhe mbajnë titullin PhD të fituar jashtë vendit. Të gjitha këto IAL i ka realizuar me procedura të rregullta ligjore dhe disponon dokumentacionin e nevojshëm, i cili ruhet pranë zyrës së burimeve njerëzore. Gjatë vizitës në institucion u verifikuan disa praktika të tilla dhe nuk u gjetën mospërputhje me ato që ka deklaruar më parë ky IAL.

Udhëheqësit klinikë të praktikave profesionale që zhvillohen në këtë program studimi janë specialist të aftë e me ambicje profesionale. Kjo i bën ata që të punojnë në mënyrë të përditshme, krahas punës për të udhëhequr specialistët, për të rritur aftësitë e tyre profesionale, kërkimore e përsosjen e teknikave e protokolleve të reja të ushtrimit të Kirurgjisë Orale. Bashkëpunimi i këtyre tutorëve me specialistë të huaj që kryejnë këtë rol në programin e studimit, është bërë një rast i mirë për shkëmbim përvojë midis individëve dhe institucioneve që marrin pjesë në realizimin e programit. Ka dhe marrëvesht bashkëpunimi midis institucioneve të AL, të hartuara e lidhura sipas ligjit, por që i shërbejnë aftësimit reciprok të specialistëve të kësaj fushe, kryesisht specialistëve shqiptar që kanë patur nevojë për eksperiencën e huaj në këtë fushë.

Udhëheqësit klinikë të praktikave që kryejnë specialistët në këtë program studimi SPA, janë vëzhgues, këshillues e pjesëmarrës duke ndihmuar në çdo rast, në mënyrë konkrete e direkt në zgjidhjen e situatave klinike apo të ndërhyrjeve operatore. Ata kryejnë këshilluesin, por në rast nevojë dhe asistentin në mënyrë që procedura përkatëse të realizohet sa më realisht dhe me saktësinë e nevojshme. Në këto raste ata vlerësojnë punën e specialistit, por organizojnë diskutime edhe me kolegët e tjerë për vlerësimin e punës së kryer duke vënë theksin në atë që mund të bëhet më mirë. Në IAL kjo praktikë ka

Vasmi Renci
[Signature]

[Signature]

Kriteri 7 Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specialistit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.

Kriteri 8 Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.

Kriteri 9 Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specialistin.

Kriteri 10 Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.

Kriteri 11 Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrtuar specialistin.

funksionuar në mënyre normale dhe është monitoruar përparim dhe rritje e aftësive klinike të specialistëve në mënyre dinamike e të vazhdueshme.

Udhëheqësit klinikë të praktikave profesionale në këtë program studimi, kanë ekspertizën e duhur profesionale dhe eksperiencën e nevojshme për të udhëhequr specialistët në realizimin me sukses të detyrave të programit. Ata zotërojnë teknikat e duhura operatore, por edhe protokollet për realizimin e tyre. Ata njohin përmbajtjen e këtij programi studimi, kanë informacion të plotë mbi përmbajtjen e syllabuseve që zhvillohen dhe përpiqen t'i konkretizojnë ato me raste klinike që demonstronë njohuritë teorike, por dhe konsolidojnë shprehë praktike të nevojshme në fushën e Kirurgjisë.

Udhëheqësi i programit të studimit SPA që ka ofruar Albanian University, ka krijuar kushte reale për zhvillimin normal të praktikave profesionale që janë një pjesë e rëndësishme e këtij programi. Duke marrë në konsideratë numrin e studentëve që kryejnë praktikat profesionale dhe që është konform shtojcës nr.2 për këtë problem, tutori i programit në praktikat klinike udhëheq jo më shumë se 3 specialistë, shpesh herë 1-2 të tillë.

Udhëheqësit e këtij programi studimi, që kryejnë detyrën e tutorit në praktikat klinike kirurgjikale, janë mjek të aftë e me përvojë dhe pa përjashtim të specializuar në fushën e kirurgjisë orale. Ata plotësojnë kritere profesionale, shkencore e akademike për të kryer një detyrë të tillë. Ata janë të specializuar në fushën e specializimit që ndjekin specialistët e këtij programi dhe në këtë fushë janë me stazh profesional dhe aftësi klinike e mjekësore.


Ndërkohë që kryhen praktikat klinike profesionale në këtë program studimi, në Klinikën "Çerçiz Mingomataj" të AU që është një institucion ndihmës në realizimin e këtij programi, ndodhen më shumë se një specialist apo mjek kirurgë që vëzhgojnë ecurinë e këtij programi studimi. Megjithatë, çdo specialist ka

Vera me Horci
Albani

DA ERALIN PALLA
[Signature]

	<p>tutorin e tij, prek një pikë referimi konkrete e të përcaktuar të cilit i referohet për çdo rast. Në rast se për arsye të ndryshme , njëri nga tutorët ka munguar , grupi është vënë në dijeni dhe për specializantët është kujdesur një koleg i tij. kjo u është komunikuar të interesuarve. Duhet bërë e qartë që në këtë IAL, ndoshta ndryshe nga institucionet e tjera të Arsimit të Lartë, mungesat e personelit , të studentëve dhe të specializantëve nuk tolerohen as edhe një minutë të vetëm. Prandaj rastet e mungesave dhe të vonesave janë krejtësisht të rralla e të pa përfillshme.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Krteri 1 Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni AU, ka të plotë listën e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, të cilët i ka rekrutuar sipas procedurave të rregullta ligjore e të mbështetur në Statutin , rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e programit të studimit. Personeli akademik i aktivizuar në realizimin e këtij programi studimi dhe Udhëheqësi i këtij programi SPA, kanë dokumentacion të plotë , që administrohet sipas rregullave përkatëse në dosjet përkatëse që disponon zyra e burimeve njerëzore. Të dhënat që përmbajnë këto dosje janë të plota dhe përmbajnë jo vetëm ato që lidhen me të dhënat personale e aktivitetin profesional e shkencor të pedagogëve e tutorëve të këtij programi, por dhe me të dhëna direkte që lidhen me rezultatet e tyre në këtë program studimi. Të gjitha këto u verifikuan gjatë vizitës në institucion dhe u gjetën konform kërkesave e standartit për këtë problem. Të dhëna të tilla përmban edhe dosja e paraqitur për vlerësim nga ana e IAL.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Krteri 1 Institucioni organizon programe të zhvillimit profesional të mëtejshëm të personelit akademik të angazhuar në program e të personelit mbështetës.</p>	<p>Albanian University, ka organizuar programe kualifikimi dhe disa trajnime që kanë patur për qëllim përgatitjen e stafit akademik dhe të atij mbështetës që merret me realizimin e këtij programi studimi në SPA ne “Kirurgji Orale”.. Veprimtari të tilla formuese janë zhvilluar nga pedagogë vendas e të huaj që kanë përvojë të veçantë për realizimin e programeve të tilla</p>

Vera me Hoci


DA CALVA PERA


Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash të programeve të kualifikimit.

specializimi në fushën e mjekësisë e sidomos në atë të Kirurgjisë Orale. Në dosjen e paraqitur për vlerësimin e programit SPA, institucioni ka paraqitur tematiken e trajnimeve të stafit akademik, data dhe personat përgjegjës për këtë problem, që i përket vitit mësimor 2019-2020 dhe që është miratuar në njësinë kryesore dhe nga titullari i institucionit.

AU disponon disa të dhëna të programeve të kualifikimit të personelit akademik dhe të atij ndihmës dhe që i perkasin gjithë aktivitetit akademik e shkencor të këtij institucioni. Një pjesë e veçantë e këtyre aktiviteteve lidhet me emrin e Programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale". Të dhënat rreth këtij programi u gjetën në hard copy, por edhe të ruajtura në mënyrë elektronike. Lidhur me këtë problem ky IAL, ka një përparësi të veçantë. Ai disponon një Stacion Televiziv të emërtuar UTV, i cili është një mjet mjaft efikas që njofton e propagandon për zhvillimin e veprimtarive formuese e kualifikuese jo vetëm të stafit akademik, specialistëve e të studentëve, por edhe të masave të gjera çka ka një impakt të madh social.

Standardi IV. 7- Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të përfshirë në këtë veprimtari, në rast se ka, edhe të mbështetjes financiare të institucionit ndaj tyre.

Personeli shkencor dhe akademik në AU e ka të obliguar veprimtarinë studimore shkencore. Një rregull i tillë vlen edhe për specialistët që po frekuentojnë këtë program studimi SPA në "Kirurgji Orale". IAL e mbështet moralisht e financiarisht këtë veprimtari. Ai siguron kushte për kërkimet shkencore, por edhe për menyrën e prezantimit dhe të botimit të këtyre punimeve.

Institucioni mbështet edhe veprimtarinë e personelit akademik, por dhe të specialistëve edhe për kërkime që janë kryer jashtë vendit. Në aktivitete shkencore, konferenca e Kongrese ndërkombetare, personeli akademik stimulohet që të marr pjesë në mënyrë aktive me punimet e veta, ose pasivisht si dëgjues. Institucioni ka garantuar kohën e nevojshme dhe ka bërë sponsorizime për veprimtari të tilla. Të dhëna lidhur me këto aktivitete janë të grumbulluara e

Voxani Koci

DA GRUMBULLUARA

Kriteri 2 Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit.

ruhen nga ana e IAL. Institucioni ka dhe një reviste shkencore me ISSN "OPTIME", ku botohen punimet e punonjësve të tij akademike, si dhe stimulon botimet në Revisten stomatologjike shqiptare.

AU disponon të dhëna të aktiviteteve shkencore që janë zhvilluar në vazhdimësi. Të tilla janë zhvilluar në vendin tonë, por edhe jashtë. Mund të përmendim një Kongres të përbashkët me palën italiane i zhvilluar në Avezzano të Italisë, si dhe zhvillon në mënyrë periodike Konferenca shkencore në fushën e stomatologjisë ku kanë referuar edhe kandidatët specializantë të këtij programi. Materialet e këtyre aktiviteteve shkencore ruhen në institucion si: tekstet e botuara, monografitë, artikujt apo kumtesat e mbajtura brenda ose jashtë vendit. Ruhen dhe materialet e referuara në aktivitetet shkencore të institucionit, apo jashtë tij për personelin e tij akademik dhe specializantët e këtij programi.

Konkluzionet e vlerësimit: Albanian University ka kapacitete të mjaftueshme në personel akademik, ndihmës akademik dhe administrativ për zhvillimin në kushte normale të programit të studimit të ciklit të tretë SPA në "Kirurgji Orale". Ky institucion disponon gjithashtu infrastukturën e nevojshme akademike me salla e laboratore të pajisura me të gjitha pajisjet përkatëse për zhvillimin e lëndëve teorike që bëjnë pjesë në kurrikulën e këtij programi. IAL, i ka të organizuara sipas standarteve bashkëkohore edhe strukturat ndihmëse për realizimin e plotë të këtij programi studimi.

Klinika stomatologjike Universitare "Çerçiz Mingomataj" është e organizuar dhe e pajisur me të gjitha facilitetet e duhura për zhvillimin e praktikave profesionale në nivelin shkencor e profesional të kërkesave të programit dhe të Standarteve të kërkuara.

Institucioni disponon dhe ka ruajtur sipas kërkesave të duhura dokumentacionin e duhur që lidhet me këtë program studimi dhe që shpjegon krijimin dhe funksionimin normal të programit të studimit.

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit SPA në "Kirurgji Orale", është me përvojë në këtë fushë, është më tituj dhe grada dhe garanton realizimin më sukses të këtij programi.

Personeli akademik, ndihmës akademik dhe ai shëndetësor në këtë institucion janë pëzgjedhur sipas rregullores së tij, plotësojnë kriteret akademike e ato shkencore dhe janë të mjaftueshëm për numrin e specializantëve që ndjekin këtë program.

Organizimi i programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale" në AU është bërë sipas procedurave të rregullta ligjore duke filluar që te rekrutimi i stafit akademik përkatës, caktimi i strukturave akademike e administrative në funksion të këtij programi dhe deri tek kushtet dhe procedurat e pranimit në këtë program, ecuria e tij, vlerësimi i specializantëve deri tek detyrimet përmbyllëse dhe Diplomimi i Specializantëve. Të gjitha këto u gjetën të dokumentuara sipas kërkesave të ligjit dhe të ruajtura gjithashtu konform ligjit dhe rregulloreve përkatëse dhe rregullores së programit të studimit.

Veronika Roci
Shkencëtare

Dr. GJILJA PELLA
Gjilja Pella

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, spitale, klinika, pajisjet spitalore, teknologjitë e informacionit (IT), biblioteka, shërbime të tjera për studentët.

Mjediset të ndara në Struktura Qëndrore dhe Struktura dytësore

Albanian University, ka ngarkuar Departamentin e Stomatolgjisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për organizimin dhe realizimin e programit të studimit të ciklit të tretë, SPA në 'Kirurgji Orale'. Aktiviteti mësimor i këtij institucioni zhvillohet në ish godinën e Gjykatës së Tiranës, në Rrugën e Durrësit dhe godinën e ish Hotel Internacionalit në rrugën "Kajo Karafili", që janë pranë njëra-tjetrës. Këto dy godina që janë të sakta nga ana arkitekturore, janë rikonstruktuar dhe janë përshtatur në mjedise mësimore të standartit të kohës dhe janë kompletuar me të gjitha paisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor në kushte normale. Në aktivitetin e tij mësimor, FSHM që është realizues i këtij programi, ka në dispozicion të tij një sipërfaqe funksionale prej rreth 4102 m², sipas dokumentacionit që ky institucion ka paraqitur.

Infrastruktura e FSHM është konform standartit të nevojshëm për zhvillimin e një procesi mësimor normal. Ka klasa dhe auditore me hapsira të bollshme dhe të ndriçuara e të ajrosura mirë si dhe të paisuar me mjetet e duhura teknologjike për këtë program, por dhe për çdo program studimi. Disponon një sallë konferencash, dhe ka në dispozicion të këtij procesi kompjutera, video projektore, ekrane të medha etj.

Praktikat profesionale të këtij programi studimi kryhen në Klinikën stomatologjike "Çerçiz Mingomataj" që ndodhet brenda këtij institucioni. Ka në dispozicion të programit dhe institucione mjekësore bashkëpunuese si Qendra Universitare e Traumës dhe Spitali Salus me të cilët ka marrëveshje të rregullta dhe efektive bashkëpunimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI III - INSTITUCIONI DISPONON TË GJITHA KAPACITETET INFRASTRUKTURE, TEKNOLOGJIKE DHE ORGANIZATIVE TË NEVOJSHME TË PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË	
Standardi III. 1- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve të studimit dhe në veçanti të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.	Albanian University ka një vendndodhje të përhershme që ndodhet shumë pranë qendrës së Tiranës, në rrugën e Durrësit dhe një godinë tjetër në Rr. Kajo Karafili që ndodhen pranë njëra-tjetrës. Aty ndodhet dhe Klinika Stomatologjike "Çerçiz Mingomataj", një institucion mjekësor me satndarte të kohës, e organizuar në shërbime që janë në funksion të procesit mësimor e profesional të programit të studimit dhe e licensuar sipas kërkesave të

Voxmi Koci
[Signature]

DA ERALIND PETRA
[Signature]

Kriteri 2 Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.

Kriteri 3 Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).

Kriteri 4 Institucioni disponon struktura të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike dhe didaktike. Akreditimi i këtyre infrastrukturave kryhet nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore. Objekt i akreditimit janë strukturat përbërëse pjesë të rrjetit formues të njësisë që ofron programet e studimit specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë. Për struktura nënkuptohen strukturat fizike (departamentet, njësitë operative, shërbimet, qendrat, laboratorët, poliambulatorët, etj) pjesë e rrjetit formues ku zhvillohen aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për formimin e specializantëve.

Veçanërisht objekt i akreditimit janë strukturat qëndrore të njësisë që ofron programet e studimeve specializuese afatgjata, si ato të fakultetit apo universitetit. Këto struktura si dhe menaxhimi organizativ, administrativ, didaktik dhe teknik shëndetësor dhe aktivitetet e lidhura me to, koordinimi dhe/ose drejtimi i tyre për çdo njësi që ofron programe studimi specializimi,

ligjit. Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për qëllime mësimore që prej 16 vjetësh. Të gjitha këto kanë bërë të mundur zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore dhe të praktikave mjekësore klinike në kushte normale.

Mjediset mësimore dhe ato mjekësore klinike të shërbimit dentar që shërbejnë si strukturë ndihmëse e këtij programi studimi, janë në dispozicion të IAL prej 16 vjetësh. Ato janë modifikuar e përshtatur për funksionin që kryejnë dhe kanë krijuar mundësi reale sipas standarteve të nevojshme për realizimin e këtij programi të SPA.

Kapacitetet akademike, infrastukturore dhe teknologjike të vëne nga AU, janë të mjaftueshme dhe të kompletuara konform standarteve për zhvillimin normal të programit të studimit SPA në Kirurgji Orale. IAL, disponon struktura të mjaftueshme administrative që janë në dispozicion edhe të këtij programi studimi, të cilat janë brenda gjithë parametrave të nevojshëm për të realizuar qëllimin e tyre. Ai disponon edhe struktura mjekësore klinike sipas të gjithë parametrave të nevojshëm, në të cilat është e mundur të zhvillohen në kushte normale të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet e parashikuara në programin e studimit. Klinika stomatologjike e këtij institucioni, që mban emrin e njërit prej themeluesve të saj, Prof.As.Dr. Çerçiz Mingomataj, është brenda gjithë parametrave fizike dhe e mirë arregjuar dhe ndodhet brenda godinës së AU. Kjo ka krijuar komoditet dhe e bën të mundur realizimin normal të programit të studimit. Të gjitha këto janë plotësuar sipas kërkesave të shtojcës nr.2 të specializimeve afatgjata.

Institucioni disponon struktura të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve klinike dhe didaktike sipas shtojcës Nr.2 mbi specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë. Klinika stomatologjike që është strukturë ndihmëse e këtij programi studimi, është një institucion i mirë organizuar, ka organigramën e saj,

Verësi Haxhi
Shërbimi

Dr. ERLEN SARA
70

duhet të jenë të përshtatshme dhe strukturat të pajisura mjaftueshëm për organizimin dhe realizimin e aktivitetit formues profesional specializues në fushën e mjekësisë. Edhe në rastet kur mund të ekzistojnë më shumë se një strukturë e akredituar si struktura qendrore/bazë, vetëm një prej tyre mund të konsiderohet si strukturë bazë efektive e njësisë që ofron programet specializuese afatgjata. Objekt i akreditimit janë edhe strukturat dytësore të konvencionuara me strukturën qendrore/bazë të cilat shërbejnë për të arritur ose kompletuar aktivitetin asistencial të kërkuar për formimin e specialistit, të cilat mund të jenë struktura universitare ose jo universitare, të të njëjtës strukturë spitalore ose jo. Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qendrore/bazë ose në strukturat dytësore të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qendrore/bazë e dytësore.

Kriteri 5 Akreditimi i strukturave të rrejtit formues bëhet pas verifikimit të plotësisë nga ana e IAL-së të standardeve të përshkruara në këtë dokument dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i jep të drejtën IAL-së që ofron programet specializuese të përdorë këto struktura për të organizuar e realizuar aktivitetin formues specializues për secilin specialist. Strukturat e akredituara për një specialitet të caktuar mund të shtrijnë aktivitetin formues, me kërkesë të IAL-së, edhe në specialitete të tjera me kusht që të plotësojnë të gjitha standardet dhe kriteret e parashikuara për atë specialitet.

Kriteri 6 Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera në vend, të njohura/akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, ose të huaja të akredituara për zhvillimin e programeve specializuese analoge në vendin përkatës, në bazë marrëveshjesh midis tyre.

funksionon në bazë të një rregulloreje të posaçme. Ky institucion mjekësor me karakter të dyfishtë, mjekësor dhe akademik, është i vlerësuar e akredituar sipas rregullave dhe ligjeve përkatëse si të gjitha institucionet e tjera shëndetësore të këtij lloji.

Struktura qendrore e njësisë që ofron këtë program studimi SPA, është e përshtatshme dhe konform kërkesave ligjore e rregulloreve përkatëse dhe ka menaxhim teknik dhe organizativ që bëjnë të mundur realizimin e këtij programi.

Edhe strukturat dytësore janë konform standarteve të nevojshme. Struktura spitalore IAL nuk disponon, por ka të organizuar një Day Hospital. IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me 2 struktura spitalore të nivelit të lartë si Qendra Universitare e Traumës dhe Spitali Salus. Ajo ka 2 salla kirurgjie dhe anekset e nevojshme për ecurinë normale të këtij programi studimi. Një strukturë e organizuar që shërben edhe në funksion të këtij programi është ajo e radiologjisë që realizon grafi panoramike dhe laterale.

Programi i studimit SPA në "Kirurgji Orale" në AU, ofrohet nga Fakulteti i SH. M., i cili është i akredituar me Vendim të BA Nr. 01, datë 24.01.2020, ndërsa Departamenti i Stomatologjisë realizon një program të ciklit të dytë të studimeve, i cili është i akredituar me Vendimin Nr. 88, datë 21.09.2017 dhe ka marrë vlerësim përfundimtar pozitiv nga BA, me datën 19.05.2017. Edhe Klinika Stomatologjike "Çerçiz Mingomataj", si struktura dytësore, është e vendosur në të njëjtën godinë me Korpusin e njësisë kryesore dhe ndodhet në Rr. e Durrësit, në godinën e ish gjykatës së rrethit. Ajo është e organizuar me mjediset e nevojshme që i shërbejnë mirë realizimit të programit dhe e licensuar nga strukturat përkatëse.

Në këto rrethana, ky program studimi realizohet nga struktura të organizuara, të

Vaxmi Koci
[Signature]

[Signature]

	<p>njohura dhe të akredituara nga instancat përgjegjëse të shtetit shqiptar dhe konform kërkesave ligjore e standarteve të nevojshme.</p> <p>IAL, nuk ka të organizuar programe të përbashkëta të studimeve specializuese me institucione të tjera brenda ose jashtë vendit. Ai realizon këtë program studimi SPA në bashkëveprim me disa institucione të huaja dhe vendase. Pjesëmarrja e 6 pedagogëve nga Universitet italiane, specialistë të kësaj fushe specializimi, kliniciste të njohur në Europë, është një risi e këtij programi dhe përparësi e tij. Të gjitha këto janë të rregulluara me marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve, të lidhura sipas ligjit dhe që u gjetën efektive gjatë vizitës në këtë institucion.</p> <p>Mjekëve stomatologë që janë duke kryer këtë program studimi SPA në "Kirurgji Orale", u është vënë detyrë që të njohin legjislacionin në fushën e shëndetësisë, atë të sigurimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ligjin Nr. 127/2014 "Për urdhërin e Stomatologut në R.SH."</p>
<p>Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara</p>	
<p>Kriteri 1 Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike. 	<p>Struktura qendrore dhe ajo dytësore të AU, diponojnë standarde fizike e infrastrukurore të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale". Ato janë konform standarteve të nevojshme dhe mundësojnë realizimin e qëllimit të këtij programi. Këto kapacitete janë konform kërkesave të shtojcës nr.2 lidhur me këtë problem.</p> <ol style="list-style-type: none"> Hapsirat për ushtrimin e veprimtarive mësimore, të praktikave paraklinike atyre klinike , janë të mjaftueshme plotësisht duke marr parasysh numrin e specializantëve që ndjekin këtë program. Kapacitetet teknologjike, paisjet mjekësore e aparaturat e nevojshme për shërbim stomatologjik të karakterit kirurgjikal janë të mjaftueshme, të standartit bashkëkohor, të mirëmbajtura dhe në gjëndje të mirë

Vera me Haxhi

DA SALVA PENA

Kriteri 2 Të gjitha strukturat (psh. auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) plotësojnë standardet e përgjithshme.

Kriteri 3 Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:

- a. për administratën dhe strukturat ndihmëse (sekretari didaktike, bibliotekë tradicionale dhe telematike, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët)
- b. kompjuter në dispozicion të sekretarisë dhe administratës
- c. program të kompjuterizuar për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë didaktike
- d. faqe interneti të tijin
- e. linja telefonike dhe pajisje për fotokopje
- f. salla për leksionet dhe seminarat

funksionale.

c) Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme organizative për zhvillimin e programit të specializimit. Specializantët janë të grupuar në grupe të vogla me nga 3 veta dhe që drejtohen secili nga një tutor dhe nga udhëheqësi i programit.

d) Në këtë institucion janë të siguruara edhe kapacitetet asistenciale dhe puna është e organizuar që ato të jenë të pranishme në çdo rast sipas nevojës apo tipologjisë së ndërhyrjes kirurgjikale. Të gjitha rastet klinke që operohen janë prezantuar në grupe specializantësh më të mëdha për të ndarë eksperiencat e ndryshme midis tyre. Ndërhyrjet operatore që realizohen këtu kryhen me anestezi lokale. Për gamen e operacioneve që kryhen dhe shkallën e vështirësisë që ato kanë, specializantët e ardhshëm duhet të përdorin edhe teknika anaestezie më të komplikuar siç është Sedacioni koshient dhe Anestezia e përgjithshme. Reparti i Kirurgjisë mendojnë se është mirë të asistohet edhe nga mjekë reanimator që kujdeset për jetën e pacientit gjatë ndërhyrjeve operatore.

Materialet dhe aparaturat që përdoren në këtë program specializimi janë të çertifikuara, të pajisura me çertifikatë cilësie dhe origjine të mallit dhe plotësojnë standartet e shëbimit stomatologjik bashkëkohor.

Të gjitha strukturat e ngarkuara për realizimin e këtij programi SPA janë të pajisura me ambiente dhe pajisjet e nevojshme sipas standartit dhe kërkesave të nevojshme, sipas karakterit dhe veprimtarisë që kryejnë. Ato plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike për realizimin me sukses të këtij programi. Sekretaritë, auditorët, laboratorët dhe biblioteka e institucionit janë në parametrat e nevojshme, higjenikisht të pastra, të ajrosura e ndriçuar mirë dhe me ajër të kondicionuar.

Struktura bazë e ngarkuar për implementimin e këtij programi studimi të ciklit të tretë, është e

Vera me Hoxa
Mirë

DA CALVA PERA
[Signature]

- g. laboratorë kërkimorë dhe didaktikë
- h. kompjuter në dispozicion të studentëve të pajisur me lidhje interneti dhe akses në bazat e të dhënave profesionale on line (së paku 1 kompjuter / 5 studentë)
- i. adresë poste elektronike personale për specializantët të ofruar nga struktura universitare
- j. ambulatorë dhe struktura asistenciale (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit)
- k. ambiente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2)

Ambjentet më sipër sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.

kompletuar me ambientet dhe paisjet e nevojshme që i shërbejnë qëllimit të këtij programi studimi.

a) I gjithë sistemi infrastrukturor, sekretaria mësimore, biblioteka tradicionale dhe ajo on-line, salla mbledhjesh dhe dhomë të veçantë për specializantët, janë të organizuara sipas qëllimit të këtij programi studimi dhe i shërbejnë realizimit të suksesshëm të tij. Ata janë në parametra fizike e higjienike sipas kërkesave të nevojshme dhe disponojnë paisjet e nevojshme e kushtet e duhura në funksion të tij.


b) Në sekretarinë mësimore të programit të studimit dhe në zyrat e administratës, punohet me praktika të rregullta zyrtare dhe dokumentacioni hartohet dhe është i ruajtur si në sistemin hard-copy ashtu edhe online. Për këtë punohet me kompjutera të kohëve të fundit dhe të tillë disponon edhe biblioteka dhe salla e IT, të cilat kanë pozicione pune të mjaftueshëm për studentët dhe specializantët.


c) Sekretaria didaktike e këtij institucioni, disponon një program të kompjuterizuar për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave të specializantëve në vazhdim të këtij programi dhe të atyre që e kanë kryer me para atë.

d) Ky program studimi ka faqen e tij në sitin e Universitetit që mund të aksesohet në: <https://albanianuniversity.edu.al/sqfakulteti-i-shkencave-mjeksore-2>.

Gjithashtu për komunikimin e shpejtë të specializantëve me strukturat përkatëse organizative e pedagogjike përdoren edhe rrjetete sociale.

f) Albanian University, disponon linja telefonike të mjaftueshme fikse dhe mobile me të cilat mund të komunikohet lirisht me specializantët dhe të interesuarit e tjerë. Pranë sekretarive dhe në mjedise të tjera të administratës së AU, disponohen fotokopje të cilat mund të aksesohen nga specializantët edhe shërbimi i kryer në to është pa pagesë kur

Vera me Kerci


DA ERALIA PATA


Kriteri 4 Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:

- a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite.
- b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi.
- c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.

kryhet për ata.

g) Në këtë IAL ka në dispozicion të specializantëve e të studentëve që kryejnë studimet në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, laboratorë didaktike dhe kërkimore shkencore të mjaftueshëm për kapacitetin e specializantëve dhe të studentëve që studjojnë në këtë institucion. Këto laboratorë janë të kompletuar me paisjet e nevojshme sipas karakterit për të cilin janë krijuar. Ata kanë karakter didaktik dhe i përshtaten lëndës ose modulit që zhvillohet, por kur kanë dhe karakter kërkimor, janë të paisur sipas qëllimit specifik për të cilin janë ngritur.

h) Institucioni disponon kompjutera me lidhje interneti që janë në çdo kohë në dispozicion të specializantëve dhe ku kandidatët mund të kenë në dispozicion të tyre akses, së paku 2-3 veta në një kompjuter.

i) Çdo specializant ka një adresë poste elektronike personale të ofruar nga vetë institucioni që mund të komunikoj në çdo kohë dhe në mënyrë të sigurtë me strukturat përkatëse.

j) AU disponon salla dhe kabinate stomatologjike, të mjaftueshme në sasi e në sipërfaqe dhe të paisura me veglat e aparataturat e nevojshme që janë në funksion të realizimit të programit të studimit SPA në "Kirurgji Orale".

k) Strukturë të mirfilltë spitalore ky IAL nuk ka. Ai është i pajisur me një repart ditor "Day Hospital" dhe në rastet kur është e nevojshme bashkëpunon me Qendrën Universitare të traumës dhe me spitalin Salus, me të cilët ka marrëveshje të rregullta bashkëpunimi.

Të gjitha këto ambiente që janë në funksion të këtij programi studimi, plotësojnë kushtet arkitektore dhe higjenike që bëjnë të mundur realizimin pa pengesa të programit të studimit.

Strukturat specifike që lidhen me realizimin e këtij programi studimi të ciklit të tretë në SPA për "Kirurgji Orale", janë të ngritura e

Nona me Hoxhi
Hoxhi

DA ERALIA 2012
[Signature]

Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë së 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.

Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.

funksionojnë brenda standarteve që bëjnë të mundur realizimin me sukses të këtij programi studimi. Kabinete stomatologjike të shërbimit kirurgjikal dhe sallat e operacionit si dhe strukturat e tjera ndihmëse janë sipas standarteve dhe plotësojnë kërkesat e shtojcës Nr.2 mbi këtë problem.

a) Standartet e specifike që lidhen me pranimin e pacienteve, ekzaminimet e nevojshme të karakterit kirurgjikal, vendosjen e saktë të diagnozës dhe kryerjen mbi kriteret të sakta klinike të ndërhyrjeve operatore, janë të plotësuara sipas kërkesave të programit dhe standarteve të kërkuara. Lidhur me strukturat bazë që lidhen me zhvillimin e këtij programi mendojmë se ato janë plotësuar mirë. Strukturë spitalore me shtretër ky institucion nuk disponon. Duhet patur parasysh se mbi 90% e ndërhyrjeve operatore që zhvillohen në kuadër të realizimit të këtij programi, zhvillohen në kushte ambulatorë dhe në këtë plan institucioni i ka plotësuar kushtet me salla e laboratore sipas nevojës.

b) Për raste të tjera, kur nevojitet shtrimi i të semurëve në spital, janë bërë zgjidhje alternative dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjerë si Qendra Spitalore e Traumës dhe Spitali Salus.

- c) Shërbimet e përgjithshme, analizat e ndryshme dhe kontrolli radiologjik që nevojiten për diagnostikimin e saktë në Kirurgji, para se të vendoset ndërhyrja operatore, apo monitorimi i kujdesshëm i pacientit gjatë ndërhyrjeve të çdo kategorie operacionesh që përmban ky program studimi, janë të plotësuara sipas standartit të nevojshëm. Strukturat do të ishte e arsyeshme që të kenë njësi bazë për diagnostikimin dhe realizimin e planeve të trajtimit si CBCT, Micro-CT dhe software përkatëse, LASER për kirurgji orale, Sedacioni IV ose me gaz. Këto janë kërkesa bashkëkohore për çdo lloj

Veronica Koci
Shkencë

Dr. GJILJA PETA
[Signature]

Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.

shërbimi kirurgjikal.

Programi studimit SPA në "Kirurgji Orale" që ka organizuar Albanian University, është hapur për herë të parë bazuar në Urdhërin e Ministrit të Arsimit e të Shkencës me nr. 428, datë 05.09.2011. Ai është riorganizuar sipas Urdhërit të MASR Nr.514, datë 24.10.2020. Të gjitha ndryshimet e nevojshme të këtij programi janë bërë sipas kërkesave të ligjit dhe po ashtu janë kryer brenda hapsirave të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore dhe me dijeni të institucioneve përkatëse që drejtojnë këtë sektor.

Institucioni i AL që ka organizuar këtë program studimi të ciklit të tretë në SPA për Kirurgji Orale, plotëson kriteret e struktuarve primare për organozimin me sukses të tij. Ai gjithashtu plotëson standartet edhe në strukturat e tij dytësore, ka kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe personel shëndetësor e ndihmës për të mbuluar nevojat e specialistëve dhe kërkesat e programit të specializimit. Si institucion dytësor për realizimin e këtij programi, pranë AU, shërben Klinika Stomatologjike e cila është e pajisur me 77 poltrona dentare dhe kryen veprimtarinë e saj në disa reparte. Në këtë kuadër ka dhe një repart Kirurgjie me personelin e nevojshëm e pajisjet e duhura. Kjo klinikë funksionon si institucion akademik dhe kurativ dhe menaxhohet sipas një rregjollorje që është enkas për të.

FSHM në AU që po zbaton programin e studimit SPA në Kirurgji Orale, është një institucion i organizuar dhe që tashmë ka një traditë dhe arritje në fushen e Arsimit të lartë në vendin tonë. Ai ka të organizuar njesinë kryesore dhe atë bazë dhe funksionon sipas kërkesave të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH". Për të gjitha këto, për hapjen dhe funksionimin e këtij programi studimi si dhe për riorganizimin e tij ka dokumentacion të rregullt dhe ka respektuar kërkesat dhe afatet e ligjit. Institucioni zotëron infrastrukturën e

V. ...

DA ...

	nevojshme, ka personelin e duhur akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe shëndetësor, që janë me tituj e grada shkencore, me eksperiencë akademike dhe klinike dhe mund t'a përballojnë pa vështirësi këtë program studimi.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Albanian University ka një vendndodhje të përhershme në rrugën e Durrësit, në ambientet e ish gjykatës së Tiranës, shumë pranë qendrës së saj. Këtu zhvillohet aktiviteti mësimor i këtij institucioni që prej 16 vjetësh. Ka gjithashtu një korpus tjetër në rrugën “Kajo Karafili”, që është shumë pranë ndërtesës së parë. Programi studimit zbatohet nga Departamenti i Stomatologjisë i FSHM, që janë të licensuara nga MASR dhe BA.</p> <p>Në zbatimin e programit të studimit si strukturë ndihmëse merr pjesë Klinika Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”, një institucion i mirë organizuar i ndarë në disa reparte ku bën pjesë edhe ai i Kirurgjisë stomatologjike me infrastrukturën e vet. I gjithë ky proces është organizuar në përputhje me qëllimin e programit dhe realizon objektivat e tij.</p> <p>Struktura bazë e këtij programi është e pajisur me ambientet dhe infrastukturën e duhur, të cilat janë në përputhje me kërkesat e këtij programi dhe plotësojnë standartet e nevojshme, të përcaktuara edhe në shtojcën nr.2.</p> <p>Zyra e Burimeve njerëzore disponon dokumentacionin e duhur dhe e ruan sipas rregullave përkatëse atë.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Burimet financiare për realizimin e programit të studimit SPA në “Kirurgji Orale” sigurohen kryesisht nga tarifat e specialistëve dhe nga aktivitete të tjera tregëtare të cilat specifikohen më poshtë. Të ardhurat e siguruara nga tarifat e shkollimit të studentëve e specialistëve shkojnë në dobi të rritjes së kapaciteteve infrastrukturore dhe të infrastrukturës e pajisjeve të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në këtë institucion, në këtë kuadër edhe të këtij programi studimi në SPA. Në këtë institucion funksionon një njësi e posaçme që merret me menaxhimin e burimeve financiare. Ky problem ndiqet e analizohet në mënyre periodike dhe çdo vit hartohet një raport buxhetor që është certifikuar edhe nga ekspertë të jashtëm. Ky raport përmban të dhëna të rëndësishme që lidhen me tarifat e studentëve, pagat e punonjësve, sigurimet shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat dhe shpenzime operative. Me një menaxhim të kujdeshëm ky institucion ka arritur të mbulojë shpenzimet e nevojshme edhe të këtij programi studimi dhe të bëjë investimet e duhura për të ruajtur cilësinë e zhvillimit të tij.

Duhet pranuar se kostot operative ndryshojnë në varësi të programit të studimit dhe ky program SPA në Kirurgji Orale është ndër më të kushtueshmit, për vetë veçoritë që ka dhe përgatitjen profesionale e shkencore që u jep kandidatëve që ndjekin atë. Sipas të dhënave që disponon ky

Vera e Hara

DA ERALIND PELLA

institucion, 30-33% e të ardhurave që sigurohen nga tarifat e studentëve harxhohen për qiranë e objekteve dhe shpenzime që lidhen me to si mirëmbajtja, pastrimi i tyre, ngrohja dhe kondicionimi etj. Një pjesë tjetër me rëndësi në shpenzimet e AU e zënë ato për pagat dhe sigurimet shoqerore e shëndetësore të punonjësve të brendshëm e të jashtëm si dhe shpenzimet për reklame, internet , detyrimet ndaj shtetit, pajisje e aparatura, materiale konsumi të cilat në këtë program studimi kërkohen me shumicë dhe kanë një kosto të konsiderueshme. Institucioni i Arsimit të Lartë Albanian University, është i regjistruar në strukturat përkatëse, monitorohet dhe auditohet edhe nga ana e tyre, ka një numër NIPT-i dhe është i regjistruar në Q.K.R.

Tregues të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Tabelën 7)

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën Nr. 7, tarifat për dhe gjatë shkollimit janë 30.966.000. Këtu është deklaruar se për kualifikimin e vazhdueshëm dhe trajnime të ndryshme janë planifikuar 100.000.

Shpenzimet për studentët dhe kosto për mobilitetin e tyre

Shpenzimet e planifikuara për programin e studimit SPA ju përkasin fondit të pagave, siguracioneve shoqërore e shëndetësore, honorareve për mësimdhënie e veprimtari shkencore, fondi i ekselencës dhe kosto të tjera të Departamentit të Stomatologjisë. Shpenzimet për programin e studimit SPA dhe kosto e studimit për një vit akademik për çdo specializant është planifikuar të jetë në shifrën 347.200 lekë. Kjo shifër është e barabartë me 70% të tarifës që paguan çdo specializant në këtë program studimi.

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet.


Kontrolli i brendshëm është bërë nga eksperti kontabël, përfaqësues i zyrës së auditit, i cili ka hartuar edhe Raportin e ekspertit kontabël dhe bën në vazhdimësi auditimin financiar të shoqërisë.


Kapacitetet menaxhuese financiare

Sipas dokumentacionit të paraqitur IAL, ka qëndrueshmëri financiare gjatë realizimit të programit të studimit SPA në Kirurgji Orale. Ky institucion zotëron kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave nga disa burime që ka kompania.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II. 3- Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të gjendjes financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat dhe mbështetjet financiare të programit.	Raporti i auditit i ka paraqitur të gjitha detyrimet financiare si pagat, siguracionet dhe mbështetjen financiare për programin e studimit SPA. Ai e ka të detajuar situatën e buxhetit të destinuar për realizimin e këtij programi. Informacioni këtu është i mjaftueshëm lidhur me shpenzimet e nevojshme që lidhen me gjithë procesin mësimor dhe praktikat profesionale e kërkimin shkencor.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja dhe kontratave të shërbimeve në lidhje me programin e studimit.	

Verësi Hoxha


Dr. Edlira Pella


	<p>Janë të qarta e të besueshme burimet e financimit dhe ka siguri financiare për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Raporti i auditit që është hartuar lidhur me këtë problem, ka hartuar një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të perfituara dhe të kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të këtij programi studimi në SPA për Kirurgji Orale.</p> <p>Raporti i auditit e ka analizuar eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e specialistëve në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe praktikave profesionale për realizimin e qëllimit të këtij programi studimi.</p>
STANDARDI VIII - INSTITUCIONI DISPONON DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VIII. 1- Institucioni harton një raport financiar të kostos së programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të kostove të përfshira në realizimin e programit të studimit, si kostot operacionale, kostot fikse të ambienteve dhe të pajisjeve, kostot e personelit, etj.</p> <p>Kriteri 2 Raporti financiar përmban të ardhurat e programit për vitet e kaluara akademike.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së programit të studimit dhe dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>kriteri 4 Programi i studimeve specializuese mbështetet nga një buxhet i</p>	<p>Institucioni AU, ka hartuar një Raport me të dhëna të hollësishme që pasqyron gjëndjen financiare të kostove që lidhen me realizimin e këtij programi studimi të ciklit të tretë. Në të janë të sqaruara kostot operacionale e ato të konsumit të kryer gjatë praktikave profesionale, por edhe kostot fikse të mjediseve mësimdhënëse e klinike, si dhe ato të pajisjeve e të materialeve të konsumit që harxhohen për këtë program studimi.</p> <p>Raporti financiar që ka hartuar IAL, ka të dhëna për të ardhurat e programit të studimit SPA për periudhën që nga viti 2012 e në vijim . Ato janë të qarta dhe paraqesin një situatë transparente dhe krijojnë besueshmëri mbi mundësinë e realizimit të këtij programi, dhe objektivat e tij , sipas qëllimit për të cilin ai është hapur e funksionon.</p> <p>Sipas të dhënave që janë vënë në dispozicion , ky IAL dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare të mjaftueshme gjatë zhvillimit të këtij progami studimi. Ai zotëron kapacitete gjithashtu të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave dhe ka besueshmëri në realizimin e objektivave të institucionit lidhur me komponentin që lidhet me anën financiare të tyre.</p> <p>Progami i studimit SPA në “Kirurgji Orale”, është i mbështetur mbi një buxhet të studjuar, të besueshëm e të mjaftueshëm për realizimin me sukses të tij. Ai është i arsyeshëm e i mjaftueshëm për realizimin e objektivave të programit të studimit SPA që synon të përgatis Kirurgë Oral me dije profesionale e formim bashkëkohorë, të aftë</p>

Naxmi Kaci


DA ERINDA PELLA


nijaftueshëm për të arritur objektivat e programit për çdo student.	profesionalisht për të përballuar nevojat e tregut shqiptar të shërbimit stomatologjik dhe më gjerë.
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Albanian University, që ka organizuar dhe po implementon programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale”, ka organizuar me kujdes mbështetjen financiare që lidhet me zhvillimin me sukses të tij. Situata financiare është audituar e analizuar nga ekspertë të fushës dhe është hartuar raport i detajuar për të gjithë komponentët e saj. Në të janë parashikuar të gjitha kostot e mundshme operacionale, pagat, siguracionet shoqërore e shëndetësore, qeratë dhe mirëmbajtja e objekteve, bazën materiale dhe mënyra e përballimit të tyre.</p> <p>Ka qartësi e besueshmëri lidhur me të ardhurat nga tarifat e specialistëve, grantet e ndryshme dhe burime të tjera nga aktiviteti i kompanisë. Analiza që lidhet me këtë program studimi është kryer që nga viti 2012. Sipas të dhënave ka rritje në vitet e fundit të të ardhurave gjë që tregon për një stabilitet financiar dhe krijon besueshmëri në realizimin e plotë të programit të studimit dhe të objektivave të tij.</p> <p>Një zë i rëndësishëm në pasqyrën e shpenzimeve që ka hartuar institucioni AU, është dhe ai që lidhet me veprimtaritë për studimin dhe kërkimin shkencor. Ka mbështetje të veçantë e të mjaftueshme në këtë drejtim dhe kjo është një detyrë e rëndësishme e këtij programi që ka mbështetjen e duhur edhe në këtë drejtim.</p> <p>Në këtë IAL bëhen përpjekje për të fituar grante të huaj dhe për t’u përfshirë në ato kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtë vit akademik është mundësuar një bashkëpunim me ERASMUS+ për një grant të konsiderueshëm.</p>	


6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë


Pjesa përshkrimore

Terma reference: Monitorimi nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), funksionet e saj në programet e SPA, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë.

Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 - 2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim Senati Akademik. nr. 178 dt. 23/07/2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe në përputhje me ligjin 80/15, me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik 22/12/2016, ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cila harton polilikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin c Arsimit të Lartë dhe Standartet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e AU.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka akses në të gjitha informacionet e Universitetit, duke mundësuar në bazë të politikave dhe standarteve shtetërore të cilësisë, sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen.

Vlora me Kuci


DA ERASMO PLUS


Kjo njësi në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësim Institucional harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin modeleve të raporteve vlerësuese.

NJSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë që në shtator të vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda saj, me Vendim Scnati Akademi Nr. 157/3 dt. 08/09/2016. Kështu. Në nivel njësie bazë, në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët, pedagogët, udhëheqësit e tezës
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me anëtarët e NJSBC. GVJ u njoh nga NJSBC me metodologjinë e ndjekur nga njësia për vlerësimin e punës në institucion. Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe veçanërisht në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik perara sezonit të provimeve. Ky vlerësim realizohet me përdorimin e metodologjive të ndryshme, si pyetësorë me studentët, fokus-grupe, raporte vetëvlerësimi të pedagogëve, takime periodike, ditë të hapura etj. Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime për përmirësime të mundshme në të ardhmen Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime dhe detyra për përmirësime në të ardhmen.

NJSBC realizon dy herë në vit anketime në përfundim të çdo semestri. Pyetësori realizohet përpara fillimit të sezonit të provimeve.

- Sa Studentë janë anketuar?
60% - është numri i studentëve pjesëmarrës në anketën semestrale

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyelësorët janë përpunuar dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht në këtë anketim. Vihet re se stafi akademik kënaq më së miri pritshmëritë e studentëve për realizimin e planit mësimor. Stafi akademik është i gatshëm ti vijë në ndihmë studentit për ç' do pyetje apo paqartësi lidhur e procesin mësimor. Realizimi i praktikave klinike është një tjetër cilësi karakterizuese e programit të studimit. Mendime pozitive janë dhe ato të lidhura me Udhëheqësin e programit specializues, i cili vlerësohet për profesionalizmin e lartë.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë për programin e SPA

Vanoni Koci
Shënim

Dr. Erland Pera
Shënim

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, si dhe nga Komisioni për Vlerësimin Institucional.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore etj.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit paraqiten në strategjinë e zhvillimit institucional si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë. Në përfundim të vitit akademik NJSBC ka raportin vjetor.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin në kohë të pedagogëve, tutorëve dhe strukturave të përfshira në rjetin formues.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni informon mbi rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme.</p>	<p>AU, përmes Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor metodologji të ndryshme vlerësimi për vlerësimin e proceseve mësimore, stafit, jetën studentore etj.</p> <p>Dy herë në vit në përfundim të semestrit, përpara sesionit të provimeve, realizohen pyetësorët online me studentët, për mësimdhenien, kurikulën, vlerësimin dhe transparencën në vlerësim, performancën e Institucionit të dhënat e të cilave i bëhen të ditur personelit akademik nëpërmjet Njësies Bazë.</p> <p>NJSBC përveç pyetësorëve online përdor edhe fokus grupet.</p> <p>Këto të dhëna i përfshin në vetëvlerësimin institucional.</p>
STANDARDI IX- INSTITUCIONI DISPONON NJË STRUKTURË DHE MEKANIZMAT E POSAÇME TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË DHE PERFORMANCËS SË SAJ	
Standardi IX. 1- Institucioni disponon një strukturë dhe mekanizmat e posaçme të përmirësimit të cilësisë dhe performancës së saj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ka mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe</p>	<p>NJSBC vlerëson dhe monitoron ecurinë e programeve të studimit në mënyrë periodike, duke përdorur instrumentet e duhur.</p>

Waxmi Koci

DA ERINDI PELA

<p>mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, të cilat vlerësohen për pajtueshmërinë e programeve të reja të studimit me strategjinë e institucionit apo fakultetit, metodën e hartimit të programeve dhe zhvillimit të kompetencave të përshkruara në aktet ligjore apo standardet shtetërore të cilësisë.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhohet për zhvillimin e një kulture që njeh rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në punën e tyre.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë formale dhe në dispozicion të publikut.</p> <p>Kriteri 6 Studentët dhe aktorë të tjerë nga sektori punëdhënës janë të përfshirë në procesin dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë.</p>	<p>Të gjithë veprimtarinë e saj NJSBC e realizon në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>AU ka bërë të mundur krijimin e kulturës së cilësisë në Institucion përmes organeve dhe hallkave të rëndësishme të cilat merren me sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në institucion kontolli i cilësisë është i shtrirë deri në nivelin e Njesisë bazë me ngritjen e grupeve ad-hoc.</p> <p>NJSBC për vlerësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë, bashkëpunon me Komisionin për Vlerësim Institucional në të cilin ben pjesë edhe një përfaqësues i studentëve, si dhe me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>AU, përmes Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë realizon në mënyrë periodike vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Institucioni në strategjinë e zhvillimit të tij, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë.</p> <p>Të dhënat e siguruar nga NJSBC për problematika të caktuara që lidhen me programin e studimit analizohen me seriozitet nga institucioni duke marrë masa për zgjidhjen e tyre.</p> <p>Të dhënat e grumbulluara nga NJSBC me anë të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta i shërbejnë institucionit për të hartuar dhe zbatuar strategji të reja për përmirësimin e cilësisë.</p>	


PROGRAMI I STUDIMEVE


7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Emërtimi i Diplomës (në shqip dhe anglisht), misioni dhe objektivat e programit/leve të studimit, organizimi i vitit mësimor, përmbajtja e plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/fashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Ky program studimi synon të edukojë dhe specializojë studentët të cilët në përfundim të studimeve specializuese të ofrojnë një shërbim cilësor shëndetësor të specializuar dhe bashkëkohor të pacientit. Specializanti duhet të marrë giatë periudhës së specializimit njohuri teorike dhe praktike të mjaftueshme për ushtrimin e funksionit të tij si mjek specialist në kirurgji orale. Mësimdhënia përfshin larmi formash të mësimin dhe kontrollit të dijeve përmes veprimtarive të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, programet e lëndëve dhe rregulloren mësimore. Programi i studimit të specializimit në "Kirurgji Orale" është i organizuar në Kurse të Integruara të cilat

Vera Mimi Harci


Dr. Edlira Peci


përbëhen nga module teorike që zhvillohen nëpërmjet leksioneve në auditor. Format e mësimdhënies ndahen në leksione dhe praktika klinike. Në planin mësimor paraqiten raportet e orëve për formim të përgjithshëm me ato për formim specializues.

Tregues të matshëm:

- Elementë të përgjithshëm të Programit të Studimit
 - Kohëzgjatja; (të paktën 2-4 vite)

Ky program studimi ofrohet me një kohëzgjatje prej 4 vitesh akademike, 240 ECTS, në përputhje me shtojcën nr.2 të standarteve për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të specializantëve afatgjata në fushën e mjekësisë.

Programi i SPA përfshin të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit. Bazuar në planin mësimor të Programit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci, specializanti fiton në fund të programit 240 ECTS. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se orët teorike janë 360 orë dhe orët praktike janë 4350 orë. Në planin mësimor i është dhënë një peshë e konsiderueshme pjesës praktike, mbi 80%, ashtu sikundër parashikohet në standardet shtetërorë të cilësisë për këtë cikël studimesh

Në programin e SPA në “Kirurgji Orale”, ndarja e krediteve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik janë parashikuar sipas shtojcës 1 të standarteve shtetërore. Lëndët specifike zënë 60% (145 ECTS), nga këto 14,5 % janë lëndë me zgjedhje. Lëndët karakterizuese të fushës zënë 30% (71 ECTS) nga të cilat 16.9% e tyre janë lëndë me zgjedhje. Për lëndët e formimit bazë, lëndët ndërdisiplinore ose integruese dhe për për aktivitete të tjera zënë 5% (12 ECTS). Gjithashtu 5% (12 ECTS) e krediteve janë parashikuar për provmin final/ temën eksperimentale të diplomës.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit

1 ETCS	25 orë mësimore pune të studentit
1 orë mësimore	50' minuta

- *Provimi*

Në përfundim të çdo semstri kryhet vlerësimi i praktikës klinike në bazë të ndërhyrjeve që specializanti ka zhvilluar gjatë vitit akademik. Përgjegjës dhe vlerësues kryesor për praktikën klinike është udhëheqësi i programit të studimit. Ai bazohet në regjistrimin e aktiviteteve klinike, në sjelljen e specializantëve si operator primar, i dyte apo i tretë. Megjithatë, nuk është e qarte sa raste klinike përfundon çdo specializant, nuk ka ndonjë evidencë që tregon punën e specializantëve si operator primar, i dytë ose i tretë.

Provimi përfundimtar/final konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë. Specializantët diplomohen nëqoftëse vlerësohen pozitivisht në këto prova përfundimtare (tezë eksperimentale/case report)

- Syllabus-et për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës

Vesimi Kaci
Albani

DA CALUS 2014
[Signature]

- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lëndën në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset janë hartuar dhe miratuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Analizë për cilësinë e syllabuseve

Çdo fillim viti, nën kujdesjen e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Departamenti angazhon titullarët, lektorët e lëndëve në bashkëpunim me grupin e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, në përditësimin e syllabuseve në përputhje me të rejtat më të fundit në lëndën përkatëse dhe në përditësimet e literaturës aty ku është e nevojshme.

Syllabuset pasqyrojnë temat e leksioneve, praktikave klinike apo laboreve të cilat janë në përputhje me specifikat e lëndëve përkatëse. Për të gjitha lëndët në syllabus pasqyrohet mënyra e vlerësimit të studentit duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin në provimin final, por edhe performancën vjetore.

Të dhëna për strukturat dytësore brenda ose jashtë vendit, ku studentët kanë kryer aktivitetet asistenciale (ose kërkimet e tyre shkencore):

- Universitet/Qëndër kërkimi dhe zhvillimi të Universitetit Institut/
- Fondacion/Subjekt publik/subjekt privat
- Strukturë spitalore
- Tjetër

Për realizimin e këtij programi studimi IAI ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Universitar të Traumës dhe Spitali Salus.

Të dhëna për:

- Botimet/referimet e studentëve ;
- Revistat, entet botuese ku janë botuar këto artikuj

Institucioni ofron për studentët mundësinë e paraqitjes së punimeve të tyre shkencore apo eksperimentale në aktivitetet shkencore që vetë institucioni organizon, si edhe botime në revistën “Optime” të Albanian University. Vlen të përmendet Konferenca Vjetore që organizohet çdo vit nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe ku Departamenti i Stomatologjisë ka hapësirën për të pasqyruar punime shkencore të stafit, por edhe të studentëve në bashkëpunim me pedagogët apo tutorët e tyre.

Të dhëna për provimin përfundimtar/hartimin e tezës së SPA dhe mbrojtjen e saj

Provimi përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës.

Në këtë vlerësim hyn edhe sjellja e studentit ndaj pacientit, stafit si edhe kolegëve, impenjimi i tij në punën e drejtperdrejtë mbi pacientin, por edhe ndjekja dhe asistimi në rastet klinike të trajtuara nga

Veronica Hoxhi

DA ERIND PELLA

studentët e tjerë në grup, Përveç kësaj, çdo student përgatit tezën e diplomës ku pasqyrohet eksperiencia e fituar përgjatë 4 viteve të specializimit dhe ku duhet të prezantohet të paktën një rast klinik i nisur dhe përfunduar nga vetë studenti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 6- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacionet e ofruara nga institucioni mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshme për studentët si në formë të shkruar dhe elektronike.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën të njohur si në formë të shkruar dhe elektronike rregulloret e ndryshme të pranimit të studentëve dhe të organizimit të programeve të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion për këtë program studimi si edhe në vizitën në vend, GVJ konstaton se IAL ofron të dhëna mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset. Ky dokumentacion është i disponueshëm edhe për specializantët e SPA në “Kirurgji Orale”.</p> <p>Rregulloria e programit të studimit është e detajuar dhe përshkruan në detaj procedura dhe kritere për programin e studimit.</p>
Standardi I. 7- Përmbatja e programeve të studimeve është e plotë dhe e qartë në përmbushje të objektivave të këtyre programeve.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin me sukses të studimeve, përfshirë këtu dhe kreditet (ECTS).</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të pikëve dhe notës minimale për përfundimin me sukses të lëndës/kursit.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve përfshihen në një koncept të përbashkët, në një “plan diplomimi”².</p>	<p>Programi i studimit SPA në “Kirurgji Orale” përmban një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin e studimeve. Studenti në fund të programit duhet të ketë fituar 240 ECTS.</p> <p>Ky program studimi pasqyron detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin e lëndës si edhe parashikon penalitetet në lidhje me mosfrekuentimin e lëndës, si edhe kohën maksimale se deri kur mund të zgjatet ndjekja e programit.</p> <p>Në kurrikulën e programit të studimit jepen kredite, përshkrimin e lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, rastet klinike/praktike, mënyra e vlerësimit të specializantit si edhe mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.</p>
Standardi I. 8- Institucioni bën vlerësimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Vlerësimi i programeve të studimit bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit,</p>

² “Plani i diplomimit” të studentit shpjegon kurrikulën, kurset që duhet të ndiqen për përfundimin e studimeve, mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.

Vlora Hoxha

DA ERALIND PETA

<p>Kriteri 2 Institucioni bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumentave dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese, duke përfshirë gjithë procesin në një sistem të informatizuar.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p> <p>Kriteri 4 Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit.</p>	<p>nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetsorëve në çdo fund semestri.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së NJBSC në fund të çdo viti akademik përgatit një raport të vlerësimit të brendshëm, i cili publikohet edhe në faqen zyrtare të web-it të institucionit.</p>
<p>Standardi I. 10- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH), me ligjin për profesionet e rregulluara në RSH si dhe me direktivat europiane mbi profesionet e rregulluara.</p>	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e programeve të studimeve specializuere afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.</p> <p>Kriteri 2 Kohëzgjatja minimale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata nuk është më e vogël se ajo e përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtyre standardeve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të tretë Specializim afatgjatë në “Kirurgji orale”, ofrohet me një kohëzgjatje për 4 vitesh akademike, 240 ETCS sipas shtjocës nr.1 të Standarteve për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimeve të Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë.</p>
<p>Standardi I. 11 - Hartimi dhe realizimi i programit të studimeve specializuere afatgjata në fushën e mjekësisë bëhet sipas kritereve të parashikuara.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuere afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Në studimet specializuere janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme në raport me ECTS-të totale minimale të parashikuara për programin specializues të paraqitur në shtojcën 1: 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruere 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje).</p> <p>Kriteri 3 Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 4 Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesoreve nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 5 Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës. Për këtë ngrihet një komision i përbërë nga 5 specialistë të fushës, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse, nga të cilët 2 të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë, 1 nga Urdhri Profesional përkatës dhe 2 të emëruar nga fakulteti që ofron programin specializues. Kryetar i komisionit është një nga përfaqësuesit e emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:</p> <p>a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike;</p>	<p>Programi SPA në “Kirurgji Orale” është organizuar në përputhje me legjislacion në fuqi ku 80% e ECTS-ve janë parashikuar për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20 % të ECTS-ve për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Në program janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5% për lëndë të formimit bazë për specializantin, - 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, - 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 16% e tyre janë lëndë me zgjedhje) dhe - 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 14.5% e tyre janë lëndë me zgjedhje). <p>Programit Studimit SPA në “Kirurgji Orale” ofrohet me emër dhe kurrikul të ndryshuar</p>

Vox me Hoxë

Dr. G. P. P.

<p>b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë;</p> <p>c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë;</p> <p>d. d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në rastë emergjente.</p>	<p>për t'u pështatur me aktet ligjore në fuqi. (Urdhërin e MASH Nr. 75, datë 18.02.2013)</p> <p>Kurrikula është riorganizuar në masën mbi 20% dhe me Urdhër MASR Nr. 514 datë 24.10.2019.</p> <p>Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i kryesuar nga Udhëheqësi i Programit dhe me anëtare specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara.</p> <p>Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash. Udhëheqësi i Programit nëpërmejt rasteve klinike të trajtuara nga student përgjatë 4 viteve, vlerëson performancën klinike, aktivizimin si individ dhe në grup të studentit, sjelljen me pacientët si edhe me kolegët. Në vlerësimin teorik student vlerësohet duke u bazuar në përgatitjen e temës së diplomës, e cila lidhet me rastet klinike të trajtuara nga studentit dhe ku të paktën njëri prej tyre duhet të paraqitet i përfunduar duke pasqyruar të gjithë problematikat dhe hapat e përfshira përgjatë trajtimit.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore nënligjore për programet e studimit të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë.


Sylabuset e lëndëve janë të përditësuar sipas VKM 41 dhe pëmbajnë në detaj objektivat e lëndës, temat kryesore, mënyrën e vlerësimit me notë në përfundim të detyrimeve akademike, etj.

Albanian University siguron një menaxhim efikas të informacionit në lidhje me programin e studimit SPA në "Kirurgji Orale".

Nëpërmjet Zyrës së NJBSC në fund të çdo viti akademik përgatit një raport të vlerësimit të brendshëm i cili jep informacion për mbarvajtjen e programit të studimit. Ky raport publikohet edhe në faqen zyrtare të web-it të institucionit.

Dokumentacioni përkatës

Vera me Koci


DA ERIND DALLA


8. Mësimdhënia - mësimnxënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, kontrolli i njohurive të studentëve, udhëheqja shkencore e studentit etj.

Mësimdhënia organizohet në bazë kursi për leksionet dhe në formë grupi ose nëngrupi për punët laboratorike dhe praktikat klinike.

Pjesën më të madhe të ngarkesës në planin mësimor e zënë praktikat klinike kurse pjesa tjetër i përket leksioneve, kërkimit shkencor apo aktiviteteve të tjera. Leksionet zhvillohen në sallat e leksioneve të cilat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Pjesa klinike e programit realizohet në sallat klinike të pajisura me poltrona dentare dhe ku ofrohen të gjitha mjetet dhe materialet për punën me pacientët. Frekuentimi në praktikat klinike është i detyrueshëm. Frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në masën 75%. Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Nëqoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë. Nëse ka kryer mbí 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, punët laboratorike dhe praktikat klinike, ku janë parashikuar 21 provime, nga të cilat 8 janë për praktikën si edhe punim i temës së diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore. Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren Mësimore të Programit të studimit dhe në syllabusin e çdo lënde. Metodot e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit me projekttime të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve. Specifikë e programit është diskutimi në grup i rasteve klinike.

- Format e kontrollit të njohurive (Tabelën 11)

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL rezulton se format e kontrallit të dijeve janë:

- Frekuentimi i lëndës 10%
- Detyrimet laboratorike 10 %
- Testimet gjatë vitit 20%
- Provimi përfundimtar 60%

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
Kriteri 5 Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente/metoda vlerësimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta. <u>Të drejtpërdrejta:</u> a. Ndjekje të studentëve gjatë zhvillimit të praktikave dhe angazhimi i tyre në ndjekjen e rasteve klinike konkrete; b. Vlerësimi me nota/pikë në fund të çdo viti; c. Testime paraprake dhe dytësore: provime për module, praktikë; d. Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; e. Vlerësimi përfundimtar.	Studentët vlerësohen me notë pas plotësimit të detyrimeve akademike në lëndën përkatëse. Në këtë vlerësim merret në konsideratë frekuentimi aktiv lëndës, provimet semestrale si edhe pikët e grumbulluara nga provimi final.

Vera me Hara
Hara

DA CALUD PELLA
Pella

<p><u>Të tërthorta</u></p> <p>a. Sondazhet: të studentëve të rinj/të vjetër, të të diplomuarve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të kurrikulës (pjesës teorike dhe asaj praktike, kapaciteteve logjistike infrastrukturore dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.);</p> <p>c. Intervista.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p>	<p>Udhëheqësi i programit gjithashtu merr në konsideratë edhe performancën e studentit me pacientët që trajton.</p> <p>Për vlerësimin e tij, institucioni 2 herë në vit, nëpërmjet Zyrës së NJBSC, organizon një pyetësor online përpara sezonit të provimeve. Gjithashtu aplikohen edhe intervista, fokus grupe, etj.</p> <p>Baza e të dhënave për studentët dhe realizimet e tyre ruhen në format elektronik, arkivimi i dokumentacionit është nën kujdesin e sekretariës mësimore dhe kryesekretarisë së Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>AU për kryerjen e vlerësimit të mësimdhënies përdor instrumente/metoda vlerësi të djepdrejta dhe të tërthorta.</p> <p>Vlerësimi i studentit për lëndën kryhet me notë vetëm nëse ai ka përmbushur detyrimet akademike. Në vlerësimin e studentit merren në konsideratë: frekuentimi aktiv i lëndës, plotësimi i detyrave dhe laboratoreve si edhe provimi final.</p>	


9. Studentët e SPA


Pjesa përshkrimore

Terma reference: Kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve SPA, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve të SPA, statistika, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi i SPA-ve i drejtohet studentëve. të cilët kanë notën mesatare mbi 6 dhe kanë përftuar:

- Diplomë "Master i Shkencave" në Stomatologji.
- Diplomë tjetër ekuivalente me diplomën e mësipërme, si psh: diplomë e sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi (Kopje e noterizuar). si dhe Diplomë e përftuar jashtë vendit e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme. (Në rastin e një diplome të përftuar në Universitete jashtë vëndit duhet të paraqitet njehsimi i saj nga MASR).
- Të ketë kryer me sukses provimin e shtetit përkatës konform ligjit 1017, dt.22.10.2009 " Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të ketë përftuar të drejtën e ushtrimit të profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj (e njohur në Republikën e Shqipërisë).
- Liste notash të shkollës së lartë: (originale ose fotokopje e noterizuar).
- Të ketë note mesatare të notave të ponderuara me kreditet e të gjitha viteve të programit të studimeve jo me të vogël se 6 (gjashtë)
- CV të detajuar
- Fotokopje e kartës së identitetit

Vezirë Hoxhi


DA SALVA PAPA


- Dëshmi e marrjes së njërës prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të çertifikuar në nivelin internacional, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi.

Dokumentet për konkurrim pranohen sipas njoftimit publik për pranimin e aplikimeve. Dokumentet për konkurim dorëzohen nga i interesuari në Sekretarinë e specializimeve. Me dorëzimin e dokumenteve aplikanti merr një çertifikate aplikimi si dhe informohet në mënyrë të detajuar mbi programin e specializimit. Specializanti me kete rast informohet mbi: kohëzgjatjen e programit të studimit: kushtet që duhet të plotësojë specializanti përpara paraqitjes në provimin përfundimtar: mbështetjen që institucioni i siguron specializantit nëpërmjet strukturave administrative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (labororë, biblioteka, etj.): Fitues shpallen kandidatët që kanë ftuar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.

Pikët totale janë 100 të cilat ndahen si më poshtë:

- 50 pikë testimi/intervista me gojë
- 30 pikë kurse kualifikimi në përputhje me specialitetin
- 20 pikë tnesatja e notave

Në këtë fazë departamenti bën publike rezultatet dhe i komunikon fituesve afatet e regjistrimit.

Aplikanti fiton statusin e specializantit me përfundimin e procedurave të regjistrimit

Kohëzgjatja normale e studimeve është 4 vite akademike. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është dyfishi i afatit të rregullt, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit para-ardhës.

Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura.

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në Programin SPA në "Kirurgji Orale" janë regjistruar për herë të pare në vit të parë 36 specializantë, nota mesatare 7.

Cilësia në hyrje e studentëve të programit të studimit në kirurgji orale është e mirë.

Tregues të matshëm:

- Kushte specifike të pranimit të studentëve

AU mundëson transferimin e specializantëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të tretë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja.

- Të dhëna statistikore për studentët e pranuar:

- Numri total i studentëve specializantë të regjistruar dhe numri tyre për çdo vit;
- Numri i specializantëve të regjistruar që vijnë nga jashtë njësisë që ka hapur programin e studimeve të SPA;
- Numri i diplomave të lëshuara për marrjen e diplomës së specializimit për çdo vit;
- Kohëzgjatja mesatare e studimeve të SPA dhe cila ka qenë tendenca e këtij treguesi;
- Numri dhe përqindja që zë, në nivel programi studimesh, i atyre që kanë ndërprerë studimet e SPA.
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare;
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga rajoni i Ballkanit;

Vera M. Hoxha

DA ERALD PETA

- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vendet e BE-së;
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vende të tjera të botës;

Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale”, brezi 2014 - 2017 (kur ky program studimi ofrohej me 3 vite) është 11 me një mesatare në hyrje 8.4, kurse brezi 2019 – 2023 ka të regjistruar 36 studentë, me mesatare në hyrje 6.9.

Nuk ka studentë të diplomuar duke qënë se programi i studimit është nënshtruar procesi të riorganizimit sipas legjislacionit në fuqi. Numri i studentëve që kanë ndërprerë studimit në këtë program është 0 (zero).

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL (RVB), rezulton se % e studentë nga Kosova dhe trojet të regjistruar në këtë program studimi është 66.9% (38.4% në brezim 2014 – 2017 dhe 28.5% në brezin 2019-2023. Numri i studentëve të regjistruar nga rajoni i Ballkanit është 10.5% për të dy brezat, kurse i atyre që vijnë nga vendet e BE – së është 8.5%.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 13- Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) për degën Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”. Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk ka kriter për notën mesatare për t’u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në mjekësi. Lista e vendeve më sipër përcaktohet me udhëzim të përbashkët të MASH dhe MSH.</p> <p>Kriteri 2 Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë duke vlerësuar notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 20% të pikëve totale, testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkuron për 40-50% të pikëve totale, intervistën me gojë për jo më shumë se 10-20% të pikëve totale duke përfshirë këtu, eventualisht, dhe letrat e rekomandimit nga profesorë të fushës të cilët deklarojnë se kanë patur bashkëpunim shkencor me kandidatin. Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 minuta.</p> <p>Kriteri 4 Studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (e njohur në RSH). Në rastet kur nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga specializimi dhe shlyen financiarisht pagesat eventuale që ka përfutur gjatë specializimit.</p> <p>Kriteri 5 Këshilli i Profesorëve përcakton kriteret për t’u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik. Rregullorja e specializimit duhet të ketë marrë pëlqimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.</p>	<p>Pranimi në ciklin e tretë të studimit për programin specializim afatgjatë në “Kirurgji Orale” bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015. Programi i SPA-ve i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6 dhe kanë përfutur:</p> <p>Diplomë Master i Shkencave në Stomatologji</p> <p>Diplome tjetër ekuivalente me diplomën e mësipërme.</p> <p>Bazuar në Neni 26 të rregullorës së programit, procedurat e pranimit të kandidatëve të studimit bëhet me anë të dokumentacionit, më pas shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar.</p> <p>Vlerësimi i studentit për pranimin në këtë program studimi bëhet me pikë. Pikët totale janë 100.</p> <p>Studenti paraqet Licensën, provimin e shtetit ose equivalentimin e njohur në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Kriteret për t’u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata janë të</p>

Vera ...

Da ...

<p>Kriteri 6 Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues, para se të pranohet në të.</p>	<p>pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve, janë të miratuara nga Senati Akademik. <i>Në kriteret e pranimit nuk është parashikuar si kusht njohja e gjuhë italiane duke qënë se programi ofrohet edhe në gjuhën italiane, pasi ka pedagogë të huaj.</i></p> <p>Aplikanti merr paraprakisht informacione të detajuara për programin e studimit specializues dhe fiton statusin e specializantit me përfundimin e procedurave të regjistrimit.</p>
<p>STANDARDI V - STUDENTËT</p>	
<p>Standardi V. 1- Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>	
<p>Kriteri 1 Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë specializimi dhe i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).</p> <p>Kriteri 3 Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializuese me dorëzimin e dokumentave merr një formular aplikimi në të cilën specifikohet specialiteti ku ai është pranuar.</p> <p>Për përcaktimin e njohurive dhe kapacitetit të aplikantit përveç dokumentave të paraqitura nga aplikanti, realizohet dhe një interviste e cila vlerësohet deri në 50 pikë, për të përcaktuar njohuritë dhe aftësitë e ndryshme konjitive, komunikative dhe operative.</p> <p>Institucioni shpall fitues kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.</p> <p>Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe mundohet ti përshtas ato me kriteret ligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna mbi numrin e të regjistruarve, të transferuarve dhe të larguarve nga programi i studimit të ciklit të tretë SPA në "Kirurgji Orale" si dhe ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>
<p>Standardi V. 3- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje</p>	

Vera me Roci

DA ERINDI PATA

me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit. Ato publikohen në ambientet e fakultetit.</p>	<p>Asistenti i programit në bashkëpunim me udhëheqësin dhe drejtuesin e SPA “Kirurgji Orale”, organizon në javën e parë mësimore orë të hapura ku studentët njihen në mënyrë të detajuar me programin e studimit, mënyrën e organizimit, statusit e akreditimit, etj.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit nga pedagogët.</p>
Standardi V. 5 - Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.</p> <p>Kriteri 3 Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p> <p>Kriteri 4 Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.</p> <p>Kriteri 5 Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p> <p>Kriteri 6 Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.</p>	<p>FSHM të AU dhe Klinika Stomatologjike janë cilësuar jo të mjaftueshme në vlerësimin e parë të programit të studimit. Është rekomanduar ndërtimi i një spitali pranë strukturës për këtë arsye, i cila ka qënë një nga rekomandimet e bordit të akreditimit.</p> <p>Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizimin të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike.</p> <p>Studenti ka mbështetjen teknike për zhvillimin e aktivitetit klinik fal tutorëve klinikë dhe udhëheqësit të shkollës së specializimeve.</p> <p>Praktika klinike me shërbim ndaj të tretëve disponon materialet e mjaftueshme për kryerjen e aktivitetit praktik nga specialistët.</p> <p>Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues.</p> <p><i>Rekomandohet që laboratotët në të cilat do të realizohet kërkimi shkencore duhet të përditësohen.</i></p>
Standardi V. 6- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e studentëve që kanë përfunduar programet e studimit specializuese afatgjata.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.</p>	<p>Funksionon “Zyra e Karrierës dhe Alumnit” (ZKA), e cila mbështet në mënyrë aktive të</p>

Verësi i Kësaj
Shënime


Dr. GJILJA PAPA
[Signature]


	diplomuariat në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës dhe mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit të tyre.
Standardi V. 7- Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi vjetor i studentëve bëhet sipas moduleve që ka ndjekur specialisti gjatë atij viti akademik.</p>	<p>Dija e studentit kontrollohet në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testeve sipas moduleve që ka ndjekur specialisti gjatë gjithë vitit akademik ose seancave të kontrollit të dijes, të parashikuara në rregulloren e programit të studimit.</p>
Standardi V. 8 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve	
<p>Kriteri 1 Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse; Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja; Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike; Sjellje etike dhe profesionale. <p>Kriteri 2 Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.</p> <p>Kriteri 3 Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues i cili e vlerëson atë pozitivisht ose negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikant dhe modulet e kryera si dhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si dhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi përfundimtar i specialistëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin final të njohurive të marra nga studentët.</p>	<p>Studenti jep prova në fusha ku përfshihen shkencat mjekësore klinike, embriologjia, periodontologjia, kirurgjia orale, implantologjia, patologjia orale, sëmundje të brendshme etj. Theksi është vendosur në diagnozën diferenciale.</p> <p>Studentët gjatë viteve bëjnë ekzaminime semestrale për përvetësimin dhe praktika profesionale dhe shkencore.</p> <p>Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas përmbjlljes me sukses të të gjitha detyrimeve akademike.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i studentëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin përfundimtar të pedagogëve dhe të udhëheqësit (të disponueshme vlerësime elektronike). <i>GVJ rekomandon se Vlerësimi përfundimtar duhet të bazohet edhe në numrin total të rasteve klinike të kompletuar gjatë specializimit.</i></p>
STANDARDI VI- INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA	
Standardi VI. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Biblioteka vë në dispozicion të programit të studimit një listë titujsh aktualë të literaturës së detyruar, e cila ndodhet realisht në bibliotekë.</p> <p>Kriteri 2 Biblioteka zotëron një listë të botimeve periodike dhe programeve</p>	<p>FSHM vë në dispozicion të studentëve të tij rreth 421 tituj librash në fushën e shkencave</p>

Verësimi Kollç
Shkollë

Dr. Edmond Kollç
Shkollë

<p>komputerike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Kriteri 4 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>mjekësore me rreth 1224 kopje. Në bibliotekë gjëndet literatura e detyruar për programet mësimore, literaturë ndihmëse. Biblioteka e shkencave mjekësore vë në dispozicion të studentëve të SPA në “Kirurgji orale” rreth 144 tituj librash në fushën stomatologjike, 25 janë specifike të fushës specializuese me format e-book pdf në gjuhën angleze. Në bibliotekë gjenden edhe 44 tituj të tjerë librash në gjuhën angleze për specializantët.</p>
<p>Standardi VI. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise të përshtatshme mësimore dhe struktura klinike.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka laboratorë, klasa, zyra, studio, auditore dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit, si dhe në përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturat klinike pjesë e rrjetit formues për zhvillimin optimal të programit specializues.</p>	<p>Në funksion të programit, Institucioni ka ngritur laboratorë mësimor si: klasa, mjedise të tjera me aparatura, pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që janë të përshtatshme për mësimdhënie por duhet përmirësuar për pjesën klinike, praktike dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion Klinikën Stomatologjike të pajisur me 77 poltrone dentare, salla ndërhyrjesh kirurgjikale dhe terapie stomatologjike, e cila funksionon sipas një rregullore të posaçme.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni ka të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit kriteret e pranimit të specializantëve në programin e studimit SPA në “Kirurgji Orale”.</p> <p>Institucioni informon studentët e SPA në “Kirurgji Orale” në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit, etj</p> <p>Laboratorët për kërkimin shkencor duhet të përmirësohen. Klinika Universitare është vënë në dispozicion të specializantëve. Rekomandimi nr.2 i Bordit të Akreditimit me Vendim nr 27, datë 19.05.2017, është plotësuar pjesërisht.</p> <p>Shumica e leksioneve dhe praktikave janë në gjuhën italiane, pa përkthim të çastit. Njohja e gjuhës italiane duhet të jetë në kriteret e pranimit në një kurs specializimi të tillë.</p> <p><i>Rekomandohet ngritja e një strukture spitalore pranë Universitetit në funksion të këtij program studimi.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon se Vlerësimi përfundimtar duhet të bazohet edhe në numrin total të rasteve klinike të kompletuar gjatë specializimit.</i></p>	

Vera mi Hoci


Dr. GJERGO PULLA


POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja në kërkime të studentëve të SPA.

Pjesa përshkrimore:

Term reference: politikat e kërkimit shkencor të IAL, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja e studentëve specializantë në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, etj.

Programi i studimit SPA në "Kirurgji Orale" udhëhiqet nga politikat Instiucionale të forcimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor. Departamenti i Stomatologjisë, Këshilli Drejtues i SPA Kirurgji Orale, ka respektuar standartin për cilësinë e personelit të angazhuar në këtë program studimi. Për realizimin e këtyre programeve janë angazhuar profesorë, profesorë të asociuar dhe doktorë të diplomuar në universitetet përëndimore dhe në vend. Stafi ndërkombëtar është një vlerë e shtuar për këtë specializim.

Elementët e kërkimit shkencor aplikohen në realizimin e çdo syllabusi. Prezantimet elektronike, analizat e çështieve të ndryshme, projektet me karakter kërkimor, konferencat janë pjesë integruese e kërkimit shkencor në njësinë bazë. Studentëve u kërkohet që së bashku me pedagogët të realizojnë punime që kërkojnë përfshirjen e gjerë të tyre. Studentët e programit specializues mësojnë të bëjnë investigime, të dalin në konkluzione dhe të prezantojnë gjetjet e tyre.

Kërkimi shkencor është një tregues i veprimtarisë kërkimore e shprehur nëpërmjet konferencave Shkencore, botimet në revista, kërkimet në bashkëpunim me institute apo udhëheqjen e temave të Diplomës brenda dhe jashtë universitetit, etj.

Veprimtaria kërkimore shkencore ne kete Institucion bazohet:

- në realizimin e kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve,
- në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij,
- në integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie,
- në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore tek specializantët.

Dokumentacioni përkatës

1. Të dhënat për vitin 2016-2019
2. Projekte të aplikuara në shkollën e specializantëve nga Udhëheqësi i Shkollës Specializimeve
3. Pjesëmarrësit si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare
4. Konferenca të organizuara nga FSHM dhe Departamenti i Stomatologjisë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 4 - Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.	
Kriteri 1 Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit. Kriteri 2 Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për: a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për	Specializantët angazhohen në punën klinike e kërkimore dhe rezultatet e kërkimit i prezantojnë në konferenca shkencore të organizuara nga Universiteti.

Vera me Hoxhi
Hoxhi

DR ERIND PAPA
PAPA

<p>veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj.;</p> <ol style="list-style-type: none"> Punën e pavarur në laborator/klinikë; Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit; Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit. <p>Kriteri 3 Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligjërata; Seminare; Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik. <p>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.</p> <p>Kriteri 4 Studenti fiton aftësi³ për komunikimin e duhur me nivel profesional</p> <p>Kriteri 5 Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.</p>	<p>Specializantët përvetësojnë metodologji dhe njohuri klinike dhe kërkimore, duke u aftërsuar si nga ana teorike dhe nga ajo praktike klinike.</p> <p>Specializantët marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre klinike.</p> <p>Specializantët fitojnë aftësi për komunikimin e duhur me nivelin profesional, fitojnë kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikulimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegëve; zotesinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, bashkëpunëtorët ose vartësit e tyre.</p> <p>Specializantët kryejnë aktivitetin e tyre teoriko-praktik bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e tjera.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Angazhimi kërkimor i specializantëve dhe puna në ekip duhet implementuar në aktivitete, revista kombëtare e ndërkombëtare (ka vetëm një botim në revista ndërkombëtare, COIR Journal).</p> <p>Stafi ndërkombëtar është një vlerë e shtuar për këtë specializim në “Kirurgji Orale”</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar në funksion të programit të SPA

Pjesa përshkrimore:

Terma reference: bashkëpunimi i Shkollës së SPA me institucione/organizata kërkimore në nivel kombëtar/ndërkombëtar, personeli akademik i fuar, etj.

Referuar strategjisë së Insilucionit për kërkimin shkencor një vëmendje e veçantë i kushtohet bashkëpunimit me Universitete të tjera, sidomos ato të huaja. FSHM ka realizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi për këtë program studimi me disa univcrsitete si: Universitetin Federico II të Napolit, Universitetin e Aquilas, Universitetin e Selanikut. Grigore Popa Iasi dhe me Institucione si me Urdhërin e Stomatologëve të Shqipërisë dhe Shoqatën e Ortodontëve Shqiptarë.

- Shkëmbimin e stafeve akademike, personelit kërkues shkencor dhe studentëve;

³ Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikulimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.

Veronika Koci

Dr. GRIGORE POPA

- Shkëmbim të publikimeve, materialeve shkencore, projekteve kërkuese;
- Zhvillimin e projekteve kërkimore;
- Organizimin e publikimeve të përbashkëta, konferencave dhe workshopeve.

